

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6031
E hënë, 8 qershori 2020
çmimi 0.40 €

Në Kosovë, rreth 100 mijë tē infektuar në vit nga sëmundjet ngjitet Faqe 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAIP KAMBERI Faqe 4-5

LISTA E PËRBASHKËT DO T'I FUQIZOJË SHQIPTARËT E LUGINËS

- Synojmë t'i kemi tre deputetë shqiptarë në Parlamentin e Serbisë

Kryetari i Partisë për Veprim Demokratik (PVD), Shaip Kamberi, ka ftuar shqiptarët e Luginës së Preshevës që të dalin sa më shumë në zgjedhjet nacionale serbe të cilat do të mbahen më 21 qershori. Në këtë

intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka bërë me dije se garimi i pesë subjekteve politike shqiptare në një listë të përbashkët në këto zgjedhje do t'i fuqizojë politikisht shqiptarët në Serbi. Kamberi ka treguar se pritet

janë që shqiptarët t'i kenë tre deputetë në parlamentin serb. Sipas tij, vetëm në këtë mënyrë do të mund t'i imponohen qeverisë së re të Serbisë për zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve Faqe 4-5

EPIK-u: Qeveria pa adresë politike dhe institucionale për procesin e integrimit evropian Faqe 3



Qeveria miraton lehtësimin e masave kundër Covid-19, hap kufirin me Shqipërinë Faqe 5

ENGELI: MCC-ja NUK ËSHTË DASHUR T'I BLLOKOJË FONDET PËR KOSOVËN Faqe 3



RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

VETËM NË KATËR MUAJT E PARË TË KËTIJ VITI U REGJISTRUAN MBI 37 MIJË PUNËKËRKUES NË KOSOVË Faqe 8

PANDEMIA COVID-19 ZVOGËLON TË HYRAT TATIMORE NË KOSOVË Faqe 9

ZEKA: PASOJAT E PANDEMISË NË EKONOMI DO TË VËREHEN EDHE NË VITIN 2021 Faqe 8

SPORT

DRENICA E ZBRET BALLKANIN NGA FRONI Faqe 18

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiqi: Po e pres propozimin për zgjidhjen e çështjes me Kosovën

Beograd, 7 qershor - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka deklaruar se heqja e masave të reciprocitetit ka krijuar hapësirë për dialogun me Kosovën. "Kjo gjë e hapë mundësinë që ne të fillojmë bisedimet, nëse ajo masë mbetet për më shumë se disa ditë dhe besoj se nuk është çështje përndjekjeje dhe rivaliteti në mes të dy palëve, por një çështje thelbësore, çështje e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe kapitalit, një nga liritë më të rëndësishme të botës moderne dhe besoj se do të ketë një efekt të mirë në ekonominë e Beogradit dhe Prishtinës, do të ketë një efekt të mirë te njerëzit. Pra, jo vetëm serbët, por edhe shqiptarët, kjo do të krijojë një lloj kornize në mënyrë që komunitetet tona të biznesit të mund të bashkëpunojnë më mirë. Sigurisht kjo do ta hapë mundësinë e dialogut politik në mes nesh", ka thënë Vuçiqi

në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". Ai ka thënë se është duke pritur ardhjen e përfaqësuesit special të Bashkimit Evropian për dialogun ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, Miroslav Lajçak, në Beograd dhe Prishtinë pas zgjedhjeve të 21 qershorit në Serbi.

Po ashtu, Vuçiqi ka thënë se ka hequr dorë nga, siç është shprehur ai, nismat e mëdha për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe se është duke pritur propozimin. "Unë nuk shoh asnjë sepse kur e kam parë, të gjithë më kanë thënë se çfarëdo që shoh është e keqe. Të gjithë ata që janë jashtë Ballkanit dhe nuk kanë asnjë lidhje me serbët dhe shqiptarët do të ishte më e mirë të zgjidhni problemin sesa ata që ishin të përfshirë drejtpërdrejt në problem, pra serbët dhe shqiptarët. Kjo është sjellja e fuqive të mëdha për më shumë se 150 vjet në këto treva. Ata kanë interesin e tyre, ata



kanë vendimet e veta dhe mendojnë se është e rëndësishme që qëllimet e tyre të respektohen, të përbushen dhe nuk u intereson se çfarë mendojnë vërtet serbët dhe shqiptarët. Kjo është arsyeha kur isha në Kombet e Bashkuara dhe thashë: ‘Lérini popujt e Ballkanit t’i rregullojnë marrëdhëniet e tyre vetë dhe në të kaluarën do të kishte pasur shumë më pak gjak dhe shumë

A close-up photograph of President Vucic speaking at a podium with microphones. He is wearing glasses and a dark suit. The background is blurred, showing a blue wall with a crest or logo.

Meta: Marrëveshja Rama - Basha për reformën zgjedhore, hap i rëndësishëm

TIRANË, 7 QERSHOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, e ka cilësuar hap të rendësishëm arrijet e konsensusit për ndryshimet në Kodin Zgjedhor ndonëse ka lënë të kuptohet se kishte pritur ndërhyrje më thelbësore në ligjin elektoral. "Mendoj se është hedhur një hap i rendësishëm përpëra. Kam parasysh se do të kishte pasoja nëse nuk do të kishim një marrëveshje konsensual me palëve. Ndoshta ka shumë qytetarë që nuk janë shumë të lumtur sepse kanë pritur ndryshime edhe më thelbësore të sistemit por, sidoqoftë, fakti që kemi një marrëveshje konsensual është shumë pozitive, pasi do të kishte pasoja nëse do të kishte një reformë të njëanshme zgjedhore", është shprehur Meta në një prononcim për mediat në Shqipëri. Më tutje Meta i ka



quajtur lajme të rreme ato të publikuara për përfshirjen e këshilltarit të tij, Ilir Kulla, në skandalin për zhdukjen në Shqipëri të disa kontejnerëve me mbetje nga Italia në vitin 2017.

Basha: S'do të humbasim asnjë minutë me një qeveri të dështuar, zajedhjet do t'i fitojmë

TIRANË, 7 QERSHOR - Në një deklaratë të shkurtër për media, kryetari i Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, ka thënë se fokusi i partisë së tij kur ta marrë pushtetin do të jetë ringritja ekonomike e vendit. Basha është shprehur i bindur se opozita do t'i fitojë zgjedhjet e ardhshme dhe se do t'ua kthejë ekonominë shqiptarëve pasi, sipas tij, qeveria Rama ka zhvatur Shqipërinë. "Sfida më e madhe e çdo familje, e çdo shqiptari, është kriza ekonomike. Kjo krizë nuk mund të zgjidhet nga ata që zhvatën Shqipërinë. Ndaj e gjithë vëmendja jonë është tek e ardhmjë. Ndaj PD dhe opozita e bashkuar janë të vendosura ta paraqesin platformën ekonomike kudo në Shqipëri. Ne do t'i fitojmë zgjedhjet, do ta kemi në fokus ringritjen ekonomike. Ky do të jetë përgjendrimi i të



gjitha energjive tonë. Do ta përqendrojmë gjithë energjinë tonë te fitorja e zgjedhjeve të ardhshme dhe zgjidhja e krizës së rëndë ekonomike, duke ua ofruar planin tonë shqiptarëve, për t'ua kthyer ekonominë atyre. S'do të humbasim asnjë minutë me një qeveri të dështuar", është shprehur Rasha

Nga sot nisin provimet për maturantët në Shqipëri

TIRANË, 7 QERSHOR - Ministrja e Arsimit në Shqipëri, Besa Shahini, ka thënë se janë duke e përmbyllur vitin shkollor falë përkushtimit të nxënësve dhe mësuesve. Ajo ka thënë se tani do të fillojë fazë finale e maratonës, ku do të nisin provimet e maturës. "Arritëm ta mbyllim

këtë vit të vështirë shkollor falë qëndrueshmërisë së nxënësve, durimit të prindërve dhe përkushtimit të jashtëzakonshëm të mësuesve tanë që brenda një kohe të shkurtër e përballën me sukses realitetin e krijuar nga tërmeti shkatërrues dhe pandemia vdekieprurëse.

Mirënjohe të veçantë për secilin prej jush. Tashmë jemi në atë “fazën finale të maratonës” për maturantët tanë, të cilët ditën e nesërme kanë provimin e parë të Maturës Shtetërore. Suksese të përzemërtë secilit prej tyre në çdo provim dhe i dëshiroj gjithë të mirat në rrugëtimin

e tyre jetësor”, ka shkruar Shahini në llogarinë e vet në “Facebook”. Nga sot (e hënë) maturantët në Shqipëri do t’i nisin provimet e gjuhëve të huaja, ndërsa më 11 qershor do ta jepin provimin e gjuhës shqipe. Më datë 15 qershor maturantët do ta jepin



provimin e Matematikës, kurse më 18 qershori do ta jepin provimin e Lëndës me zgjedhje.

Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit të Qeverisë së ShBA-së (MCC) ka rifilluar programet e ndihmës për Kosovën

Engeli: MCC-ja nuk është dashur t'i bllokojë fondet për Kosovën

Kryetari i Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve, Eliot Engel, i është gjuar rifillimit të programeve të MCC-së në Kosovë. Ai ka deklaruar se MCC-ja nuk është dashur t'i bllokojë fondet për Kosovën. Pas vendimit të qeverisë për shfuqizimin e reciprocitetit me Serbinë, Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit ka njofuar se do t'i zhbllokojë programet për Kosovën të cilat ishin pezulluar në muajin mars të këtij viti

**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISSHTINË, 7 QERSHOR - Kryetari i Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve, Eliot Engel, ka mirëpritur rifillimin e programeve në Kosovë të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC). Megjithatë, Engel nëpërmjet llogarisë së vet në "Twitter" ka kritikuar MCC-në që në muajin mars pezulloi disa programe të zhvillimit ekonomik në Kosovë, duke thënë se nuk është dashur t'ë bëhej një gjë e tillë. "Jam i lumtur që MCC ka rifilluar punën në Kosovë. Nuk do të duhej fare që t'i pezullonte

fondet. Kosova ka plotësuar kriteret e MCC-së. Ngrirja e fondeve të MCC-së për ta detyruar Kosovën që t'i ndryshojë politikat është kundër asaj që vetë MCC-ja qëndron", ka shkruar Engel.

Më 6 qershori, në ditën kur Qeveria e Kosovës shfuqizoit vendimin për reciprocitetin me Serbinë, Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit ka njofuar se do t'i zhbllokojë programet për Kosovën, të cilat ishin pezulluar në muajin mars të këtij viti. Në një komunikatë për medie, MCC-ja ka vlerësuar se mirëpret vazhdimin e partneritetit me Qeverinë e Kosovës. "Shtetet e



Bashkuara mirëpresin zgjidhjen e çështjeve të tarifave dhe heqjen e masave të reciprocitetit ndaj mallrave serbe. MCC do ta rinisë zbatimin e programeve në Kosovë. Mirëpresim vazhdimin e bashkëpunimit me popullin dhe Qeverinë e Kosovës, në punën tonë të përbashkët për ta zbutur varfërinë përmes rritjes ekonomike", është thënë në njofumin e MCC-së. Pas njofimit të MCC-së për zhbllokimin e fondeve për

Kosovën, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se partneriteti me Uashingtonin është rruga e vetme që çon drejt një t'ë ardhmeje t'ë sigurt për Kosovën. "Zhbllokimi i fondeve të MCC-së është një lajm tjetër i mirë për Kosovën. Miqësia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ka çmim. Partneriteti i përhershëm me Uashingtonin është rrugë e vetme që çon drejt një t'ë ardhmeje t'ë sigurt për Kosovën, në paqe e prosperitet

për gjithë qytetarët tanë", ka shkruar presidentin në profilin e tij në "Facebook".

Po ashtu, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka mirëpritur vendimin e MCC-së për t'i zhbllokuar fondet për Kosovën. "Qeveria e Republikës së Kosovës mirëpret vendimin e MCC-së për zhbllokimin e fondeve dhe rinisjen e zbatimit të programeve të zhvillimit në Kosovë", ka deklaruar Hoti në një publikim në "Twitter".

Rikthimin e fondeve të MCC-së për Kosovën e kanë përhëndetur edhe liderët e tjerë politikë të pozitës dhe opozitës. Ndaj këtij vendimi nuk ka reaguar vetëm Lëvizja Vetëvendosje e cila udhëhiqte qeverinë e kaluar, kur u pezulluan këto fonde. Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit kishte njofuar në muajin mars për pezullimin e programeve në Kosovë për shkak se në fuqi ishin ende tarifat kundër mallrave serbe, ndonëse ShBA-ja vazhdimisht kishte bërë thirrje për heqjen e tyre. Vlera e një programi që MCC-ja pezulloi në muajin mars kapte shifrën prej 50 milionë dollarësh.

EPIK-u: Qeveria pa adresë politike dhe institucionale për procesin e integrimit evropian

Instituti EPIK ka përhëndetur vendimin e qeverisë Hoti në lidhje me shuarjen e Ministrisë së Integrimit Evropian (MIE), por është shprehur i shqetësuar në lidhje me mungesën e një adrese politike për procesin integrues të Kosovës. EPIK-u ka theksuar se nga qeveria kërkohet urgjentisht të prezantojë një plan të quartë të tranzicionit institucional të MIE-së drejt strukturës së re qeveritare, Agjencisë për Integrin Evropian (AIE), e cila do të funksionojë në kuadër të Zyrës së Kryeministrat



vendeve të cilat tani më janë bërë shtete anëtare të BE-së. Sidoqoftë, sot dëshirojmë ta shprehim shqetësimin tonë përmungesën e adresës politike në kuadër të qeverisë së re për procesin integrues dhe krijimin e boshllékut institucional në mungesë të një plani eficient të tranzacionit të MIE-së", është thënë në komunikatën e EPIK-ut.

Më tutje, EPIK-u ka parashtruar pyetjet se çfarë do të ndodhë tani me këtë proces. "Shuarja e MIE-së është bërë, por çfarë tani? Nëse deri dje partnerët tanë evropianë kanë pasur adresë Ministrinë e Integrimit, kush është adresa e tyre politike tani? Tani më janë emëruar ministrat e rinj të qeverisë dhe janë ndarë përgjegjësitë institucionale në përpunje me Vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e

plani të tranzacionit eficient do të krijojë boshllék politik dhe paqartësi institucionale duke dëmtuar kështu agjendën integruese të vendit", është thënë në komunikatën e EPIK-ut. Ky institut ka bërë me dije se në këtë proces pret katër hapa drejt strukturës së re institucionale për integrin evropian: emërimin e njërit nga zëvendëskryeministrat përgjegjës për integrin evropian: kështu do të ekzistojë një adresë e quartë politike për procesin e integrimit evropian brenda Qeverisë së Kosovës; themelimin e Agjencisë për Integrin Evropian: Përgjegjësitë e MIE-së tani do të kalojnë në Agjencinë për Integrin Evropian brenda Zyrës së Kryeministrat. Sidoqoftë, ligjërisht AIE nuk ekziston. Po ashtu, nuk ekziston më as MIE. Rrjedhimisht, është urgjente që qeveria të dërgojë në Kuvend Projektligjin për Themelimin e

Agjencisë për Integrin Evropian; miratimin e Rregullores për AIE: Pas aktit themelues të AIE-së, qeveria duhet të miratojë Rregulloren e brendshme përfunkcionimin e MIE-së, me ç'rast do të sigurohet organizmi i brendshëm administrativ i shërbimit civil të AIE-së dhe Plotësimi-ndryshimi i akteve të ndërlidhura normative qeveritare në fushën e integrimit Evropian: Brenda qeverisë ekzistojnë shumë struktura ndërqeveritare në fushën e integrimit evropian, siç janë: Këshilli Ministror për Integrin Evropian, Forumi i Nivelit të Lartë për Koordinimin e Donacioneve etj. tani qeveria duhet të sigurojë plotësimi-ndryshimin e gjithë legislacionit sekondar për ta reflektuar rolin e zëvendëskryeministrat për Integrin Evropian dhe të AIE-së. "Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë e procesit integrues dhe përgjegjësitë e deridjeshme të MIE-së, ftojmë kryeministrin Hoti që urgjentisht ta emëroj njërit nga zëvendëskryeministrat përgjegjës për procesin integrues dhe përgjegjësitë e deridjeshme të MIE-së, ftojmë kryeministrin Hoti që urgjentisht ta emëroj njërit nga zëvendëskryeministrat përgjegjës për procesin integrues duke siguruar një tranzicion eficient të MIE-së në Agjencinë e re për Integrin Evropian me miratimin sa më të shpejtë të Ligjt për Themelimin e AIE-së", është thënë në komunikatën e EPIK-ut.



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAIP KAMBERI

LISTA E PËRBASHKËT DO T'I FUQIZOJË SHQIPTARËT E LUGINËS

- Synojmë t'i kemi tre deputetë shqiptarë në Parlamentin e Serbisë

Kryetari i Partisë për Veprim Demokratik (PVD), Shaip Kamberi, ka ftuar shqiptarët e Luginës së Preshevës që të dalin sa më shumë në zgjedhjet nacionale serbe të cilat do të mbahen më 21 qershor. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka bërë me dije se garimi i pesë subjekteve politike shqiptare në një listë të përbashkët në këto zgjedhje do t'i fuqizojë politikisht shqiptarët në Serbi.

Kamberi ka treguar se pritet janë që shqiptarët t'i kenë tre deputetë në parlamentin serb. Sipas tij, vetëm në këtë mënyrë do të mund t'i imponohen qeverisë së re të Serbisë për zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve

EPOKA ERE Muhamet KOCI
PRISHTINË, 7 QERSHOR - Kryetari i Partisë për Veprim Demokratik (PVD), Shaip Kamberi, ka deklaruar se shqiptarët e Luginës së Preshevës mund të fuqizohen politikisht në zgjedhjet e përgjithshme të Serbisë të cilat do të mbahen më 21 qershor. Ai ka bërë me dije se bashkimi i pesë subjekteve politike shqiptare në një listë të përbashkët zgjedhore në këto zgjedhje ka shtuar gjasat që shqiptarët të përfaqësohen me tre deputetë në parlamentin serb. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se

vetëm në këtë mënyrë mund t'i imponohen qeverisë së re të Serbisë për zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve në këtë rajon. "Synimi i këtij bashkimi në një listë të arrijmë më tepër mandate të mundshme të përfaqësimit në nivel qendror. Deri më tanë kemi qenë të përfaqësuar me një, rrallëherë me dy deputetë. Këtë herë, për shkak të numrit më të madh të subjekteve pjesëmarrëse, synojmë tre mandate. Kjo do të rrisë fuqinë tonë politike dhe përfaqësuesë dhe shpresojmë t'i imponohemi qeverisë qendrore për partneritet për zgjidhjen e problemeve tona", ka thënë Kamberi.

Kamberi, i cili është edhe kryetar i Komunës së Bujanocit, ka vlerësuar se arritura e këtij synimi nuk është e lehtë, duke shtuar se kjo do të varet nga disa faktorë. Kamberi ka deklaruar se shqiptarët e Luginës duhet të dalin sa më shumë në këto zgjedhje. "Megjithatë, kjo nuk është një çështje absolute, meqë rezultati përfundimtar varet nga shumë faktorë: numri i qytetarëve shqiptarë që dalin në zgjedhje, votat valide që mbeten për numrin e që janë relevante për ta përcaktuar kuotën mesatare për një mandat, por në radhë të parë rezultati ynë do të varet nga serioziteti i partive nënshkruese me të cilat do t'i qasemi këtij procesi", ka deklaruar ai, duke shtuar se këto subjekte politike duhet të janë shumë aktive për ta bindur elektoratin për ta përkrahur këtë listë të përbashkët. Kamberi ka treguar se partitë shqiptare (PVD, APN, PD, LPD e LR) do të garojnë me një listë të përbashkët me 11 kandidatë nën emërtimin "Alternativa e Demokratike Shqiptare - Lugina e Bashkuar". Në këtë intervistë ai ka folur edhe përvendimin e Qeverisë së Kosovës për heqjen e reciprocitetit me Serbinë dhe për pritet që kanë shqiptarët e Luginës për qeverinë Hoti.

"Epoka e re": Z. Kamberi, Qeveria e Kosovës sot ka hequr reciprocitetin ndaj Serbisë. Si e keni parë këtë veprim?

Kamberi: Reciprociteti si masë ndaj Serbisë duhet të jetë në

funkcion të shumë çështjeve të rëndësishme për Kosovën. Sipas nesh, reciprociteti me Serbinë duhet të jetë në funksion edhe për të drejtat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, të cilët këtë masë e shohim si mundësi të fundit që Kosova mund ta përdorë për ta "detyruar". Beogradin zyrtar që t'i respektojë të drejtat kolektive të shqiptarëve këtu, në nivel të njëjtë me ato që bën Kosova me pakicat e sidomos me pakicën serbe atje. Në këtë fazë fillimi i dialogut me Serbinë, i cili duhet të përfundojë me marrëveshje dypalëshe, ku do të trajtohen të gjitha temat me rëndësi jetike për Kosovën, në radhë të parë karrigia në OKB, reparacionet e luftës e shumë tema të tjera po shihet si prioritet i përgjithshëm. Prandaj, nëse heqja e reciprocitetit do të jetë vetëm e përkohshme dhe vetëm në funksion të eliminimit të pengesave që kanë stopuar dialogun, le të i jepet rast dialogut. Por, duhet potencuar edhe faktin se heqja e reciprocitetit a nënkupton edhe ndërprerjen e fushatës negative të Serbisë që po bën për t'i arritur çnjohjet e pavarësisë së Kosovës.

"Epoka e re": Cila duhet të jetë qasja e kësaj qeverie ndaj shqiptarëve të Luginës së Preshevës?

Kamberi: Marrja drejtëpërdrejtë e përgjegjësive për Luginën e Preshevës dhe një përkujdesje më e madhe. Në dialogun që duhet nisur, të krijojë hapësirë që Lugina e Preshevës të marrë

trajtim nga i cili do të arrihet zgjidhja e drejtë dhe afatgjatë. Në aspektin e ndihmës financiare, qeveria duhet ose të ndërtojë fond të veçantë për Luginën ose të parashohë pikë të veçantë buxhetore për financimin e projekteve në Luginë të Preshevës.

"Epoka e re": Z. Kamberi, zgjedhjet në Serbi do të mbahen në fund të këtij muaji. Sa është përgatitur faktori politik shqiptar për këtë proces?

Kamberi: Në zgjedhjet lokale, që do të mbahen vetëm në Bujanoc, partitë shqiptare do të garojnë ndaras. Janë paraqitur pesë lista të partive shqiptare që do të garojnë për një elektorat, i cili, realisht, mund të jetë pak mbi 12 000 votues. Në zgjedhjet parlamentare kësaj radhe pesë parti shqiptare (PVD, APN, PD, LPD e LR) garojnë me një listë të përbashkët, me 11 kandidatë, nën emërtimin "Alternativa Demokratike Shqiptare - Lugina e Bashkuar".

"Epoka e re": Çfarë ndikimi do të ketë tek elektorati shqiptar kjo listë e përbashkët?

Kamberi: Synimi i këtij bashkimi në një listë është të arrijmë më tepër mandate të mundshme të përfaqësimit në nivel qendror. Deri më tanë kemi qenë të përfaqësuar me një, rrallëherë me dy deputetë. Kësaj radhe, për shkak të numrit më të madh të subjekteve pjesëmarrëse, synojmë tre mandate. Kjo do të rrisë fuqinë tonë politike dhe



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e katërt me radhë

Qeveria miraton lehtësimin e masave kundër Covid-19, hap kufirin me Shqipërinë

Nga sot (e hënë) do të lejohet qarkullimi i plotë si brenda Kosovës ashtu edhe me Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit. Në mbledhjen e së dielës, qeveria Hoti ka hequr masën e vetizolimit dhe masën e kufizimit të lëvizjes së lirë të qytetarëve. Në kuadër të parandalimit të përhapjes së koronavirusit, Ministria e Shëndetësisë do ta miratojë "Manualin për Mbrojtje nga Covid-19"

EPOKA
ERE

Muhamed KOCI

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Qeveria e Kosovës të dielën ka miratuar disa masa lehtësuese ndaj Covid-19 të rekomanuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK). Në këtë mbledhje, Qeveria e Kosovës ka marrë vendimin që nga sot (e hënë) të lejohet qarkullimi i plotë brenda vendit dhe vendet e tjera të rajonit.

Qytetarët që hyjnë në Kosovë përmes kufijve tokësorë më nuk do të detyrohen që të vetizohen. Pas këtyre vendimeve, kryeministri Avdullah Hoti ka ftuar qytetarët e Kosovës për kujdes gjatë lëvizjes së tyre. "Nga nesër lejohet qarkullimi i plotë, por me kujdes brenda dhe me Shqipërinë e vendet e tjera të rajonit. Në kuadër të parandalimit të përhapjes së sëmundjes, Ministria e Shëndetësisë do ta miratojë 'Manualin për Mbrojtje nga Covid-19'. Do të rekrutojmë 200 specialistë shëndetësorë që do ta mbikëqyrin zbatimin e masave që dalin nga ky manual. Vazhdojmë me maturi e respektim të masave përmundjen e plotë të virusit #COVID19, deri në hapje të plotë", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka vlerësuar se

lehtësimi i masave duhet të shoqërohet me rritje të disiplinës. Ai ka deklaruar se këto veprime do të mundësojnë lëvizje të lirë të qytetarëve dhe mallrave, veçanërisht për qytetarët që hyjnë në Kosovë nga Shqipëria dhe Lugina e Preshevës. Zemaj, po ashtu, ka kërkuar që të rritet numri i inspektorëve, të cilët do të monitorojnë nëse qytetarët, bizneset dhe institucionet e tjera po respektojnë rekomandimet për ta frenuar përhapjen e koronavirusit.

Kurse zëvendëskryeministri i parë, Besnik Tahiri, ka thënë se me hapjen e kufijve vendit po i kthehet normaliteti. "Po i kthehem normalitetin. Qeveria sapo vendosi hapjen e kufirit me Republikën e Shqipërisë. Një vendim i cili lehtëson qarkullimin e njëreëzë në të dyja anët e kufirit. Kufiri shqiptaro-shqiptar duhet të eliminohet tërësisht sikurse kufijtë e shteteve të Bashkimit Evropian. Qeveria e Republikës së Kosovës për çdo ditë, sa herë që të mblidhet, do të marrë vendime që normalizojnë jetën e qytetarëve, sikurse që do të vazhdojë edhe lufta përmposhtur plotësisht COVID-19", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".

Hapjen e tërësishtme të kufirit me Shqipërinë e ka përhëndetur edhe kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, duke thënë se hapja e

Abrashi propozon të nisin konsultimet për hapjen e transportit ajror

Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, në mbledhjen e qeverisë ka propozuar të nisin konsultimet për hapjen e aeroporteve. "Hapja e fluturimeve është pjesë e rëndësishme. Me lejen tuaj do t'i fillojë konsultimet me Autoritetin e Avacionit Civil, Ministrinë e Shëndetësisë dhe kompanitë ajrore që ta fillojmë sa më shpejt transportin ajror, duke respektuar masat rreth COVID-19. T'i shohim edhe praktikat e vendeve të tjera për transportin ajror", ka thënë Abrashi.

këtij kufiri nuk duhej të përbente lajm. "Të angazhojemi të gjithë për t'i rrëzuar pengesat e fundit mes Kosovës e Shqipërisë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndaj këtyre qëndrimeve ka reaguar ish-ushtruesi i detyrës së ministrit të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP), Xhelal Sveçla, duke thënë se kufiri me Shqipërinë kurrë nuk ka qenë i myllur. "Në asnjë moment kufiri i Shqipërisë nuk ka qenë i myllur gjatë qeverisë Kurti. Në çdo pikë kufitare me të gjitha vendet kanë qenë të njëjtat kufizime në qarkullim për shkak të pandemisë por, kurrë i myllur. Masat janë të publikuara në faqet zyrtare të qeverisë dhe min-

istrive, e lehtë mund të shohin të gjithë se kurrë kufiri me Serbinë, gjatë qeverisë Kurti, nuk ka qenë më i hapur se me atë të Shqipërisë", ka shkruar Sveçla.

PAS VENDIMIT PËR HAPJEN E KUFIRIT ME SHQIPËRİNË, ZËVENDËSKRYEMINISTRJA VIZITON PIKËN KUFITARE NË MORINË

Zëvendëskryeministrja Albulena Balaj-Halimaj, menjëherë pas vendimit të qeverisë për hapjen e kufirit, ka vizituar pikën kufitare në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, ku është takuar me policët kufitarë dhe ata të doganës, të cilët e kanë informuar mbi punën e kufirit dhe sfidat në të cilat po kalojnë. "Pa anashkaluar rrezikun për përhapjen e mëtutjeshtme të virusit Covid-19 dhe duke respektuar masat e reja për parandalimin e saj, u bëj thirrje të gjithë qytetarëve të republikave tona që ta vazhdojnë kujdesin maksimal, edhe pse fitorja e kësaj beteje duket e afërt. Kufiri do të hapet nesër, ndërsa edhe një herë në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës u kërkoj falje të gjithë qytetarëve shqiptarë, pasi kjo pikë kufitare do të duhej të hapej e para", ka shkruar Balaj-Halimaj në llogarinë e vet në "Facebook".



40 raste të reja me Covid-19 në Kosovë, numri i përgjithshëm shkon në 1 234

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit në vendin tonë janë paraqitur edhe 40 raste të reja me Covid-19. Sipas këtij instituti, rastet e reja me Covid-19 janë nga Prishtina, Vushtrria, Prizreni, Fushë-Kosova, Obiliqi, Skenderaj, Gjilan, Rahoveci dhe Mitrovica. "Rastet pozitive janë nga: komuna e Prishtinës 10 raste (sipas vendbanimit: 10 raste Prishtinë), komuna e Vushtrrisë 8 raste (sipas vendbanimit: 6 Vushtrri, 1

Akrashticë, 1 Maxhunaj), komuna e Prizrenit 7 raste (sipas vendbanimit: 4 Tupec dhe 3 Prizren), komuna Fushë-Kosovë 6 raste (sipas vendbanimit: 3 Fushë-Kosovë dhe 3 Miradi e Poshtme), komuna Obiliq 5 raste (sipas vendbanimit: 5 Milloshevë), dhe me nga 1 rast komuna Skenderaj (vendbanimi: 1 Likoc), komuna Gjilan (sipas vendbanimit: 1 Gjilan), komuna e Rahovecit (sipas vendbanimit: 1 Rahovec) dhe komuna e Mitrovicës (sipas vendbanimit: 1 Mitrovicë). Sot, më 07 qershori 2020, janë shëruar

6 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 890 raste", ka njoftuar IKShPK-ja. Sipas këtij njoftimi, nga 8 shkurti deri më 7 qershori 2020 në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare janë testuar gjithsej 16 674 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe prej tyre pozitivë kanë rezultuar gjithsej 1 234 raste, prej tyre 31 persona kanë vdekur. Më tutje, IKShPK-ja ka kërkuar nga qytetarët që t'i respektojnë masat e vendosura nga institucionet shëndetësore

kundër Covid-19. "Pakujdesia e disa qytetarëve gjatë këtyre aktivitetave mund ta shtojë rrezikun e përhapjes së infeksionit përderisa virusi SARS-CoV-2 është prezent dhe kështu mund të mbingarkohet sistemi shëndetësor me pasoja të paparashikuara deri në shpërthim e që mund të paraqesë rrezik për jetën e qytetarëve. Bazuar në këtë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Ministria e Shëndetësisë rekomandojnë që në mënyrë rigorozë të

respektohen masat mbrojtëse të deritashme, në veçanti zbatimi i planit për masat lehtësuese që nënkupton vazhdimin e zbatimit të mëtutjeshëm të rekombandimeve. Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, të përdorin maska, ta dezinfektojnë hapësirën dhe ajrosin lokalet, duke pamundësuar përapjen eventuale të infeksionit dhe shëmangjen e përhapjes në hapësirat e myllura", ka njoftuar IKShPK-ja.



Armand Nimani (AFP)

Në Kosovë, rreth 100 mijë të infektuar në vit nga sëmundjet ngjitëse

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Kosova nuk ka sistem të informimit shëndetësor, që do të thotë se i mungojnë statistikat e sakta për të gjitha sëmundjet. Të dhënat për sëmundje i mbledhë Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKShPK). Me sëmundje ngjitëse, në bazë të këtyre të dhënavave, gjatë një viti në Kosovë infektohen rreth 100 000 njerëz. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), 68 njerëz kanë humbur jetën nga sëmundjet ngjitëse në vitin 2017, që është edhe viti i fundit kur ky institucion i ka mbledhur këto statistika.

Por, përkundër kësaj, zyrtarët kanë thënë se gjatë pandemisë së koronavirusit ata kanë arritur të raportojnë për numrin e të infektuarve në Organizatën

Botërore të Shëndetësisë dhe në Qendrën Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve.

Lul Raka, mikrobiolog në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik në Kosovë, ka thënë se kjo ka ndodhur falë bashkëpunimit me Qendrën Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve. "Gjatë vitit të fundit kemi qenë në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve, për zbatimin e rekomandimeve të fundit nga kjo agjenci e Bashkimit Evropian. Pandemia e COVID-19 [sëmundjes që e shkakton koronavirusi] e ka ndërprerë këtë aktivitet që e kemi realizuar bashkë dhe kemi qenë në rrugë të rishikimit të kornizës ligjore dhe

të mbikëqyrjes aktive të sëmundjeve ngjitëse", ka thënë Raka.

Infektologu Sali Ahmeti ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se disa sëmundje ngjitëse në Kosovë janë autoktone, porse ka edhe të importuara. Ai ka përmendur malarien dhe virusin e Nilit Perëndimor si sëmundje që kanë arritur vonë në Kosovë dhe që kanë shkaktuar edhe vdekje. Sëmundjet infektive që prekin çdo vit një numër të popullatës janë ethet hemorragjike - krimë kongo, tularemia, tuberkulozi, gripet sezionale, fruthi, hepatitit B dhe C. "Në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovë përballemi me sëmundje të ndryshme - nga ato më të zakonshmet e deri tek ato më të ralla apo të veçanta. Kosova

njihet si vend endemik për disa sëmundje infektive, me një prevalencë dhe incidencë të lartë, duke përfshirë vdekshmëri. Në mesin e tyre janë ethet hemorragjike krimë kongo që shkaktohen nga pickimi i rriqraive", ka thënë Ahmeti.

"Gjithashtu, fruthi është një prej sëmundjeve të rënda dhe shumë infektive që zakonisht prek fëmijët e pavaksinuar", ka thënë ai. Vaksinimi ka bërë që disa sëmundje ngjitëse në Kosovë të dobësohen, por edhe të zhduken, siç është paraliza e fëmijëve dhe fruthi te fëmijët e vaksinuar. Sipas udhëheqësve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, Kosova renditet në mesin e shteteve më të suksesshme në botë sa i përket imunizimit. Vaksinimi organizohet nga

Programi i Zgjeruar i Imunizimit, në kuadër të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe ka një mbulueshmëri mbi 95 për qind. Mikrobiologu Lul Raka ka thënë se mbikëqyrja e sëmundjeve ngjitëse është një prej pikave qenësore në parandalimin dhe kontrollimin e tyre. "Në dekadën e fundit ka pasur mjaft probleme me funksionimin e sistemit të informimit shëndetësor dhe nuk kemi të dhëna të sakta. Derisa IKShPK-ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen epidemiologjike", ka thënë ai. Sipas Rakës, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse janë duke punuar sipas rekomandimeve të Bashkimit Evropian, por që për një kohë ky bashkëpunim është ndërprerë për shkak të pandemisë me Covid-19.

Precedenti pozitiv i Gjykatës Kushtetuese dhe disiplinimi i politikës



Shkruan: Hisen BERISHA

Periudha pas mocionit të mosbesimit dhe shkarkimi i qeverisë Kurti krijoj shqetësim filozofik mbi tendencat se kah po e orienton Albini LV-në dhe mund të konstatohej se: kërcënimi për gjakderdhje nga eksponentët dhe anëtarët e rëndësishëm të LV-së, përfshirë rrëthanën Agim Veliu, përkrahja që i vinte nga jashtë, sidomos nga zonja Von Cramon dhe Qeveria e Francës dhe e Gjermanisë, çojnë deri te krijimi i shumë precedentëve si zëvendësimi i kabinetit Hoti, veçanërisht Albini po krijonte predispozita për ta krijuar një "qeveri paralele" dhe se ai do mundohej që kjo qeveri në stilin e përafërt me të Lulzim Bashës në Tiranë, do të tentonte të imponohej përmes ndikimit që e majta evropiane ka në diplomacinë botërore.

Por çka ndryshoi pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese?

Zonja Von Kramon, pas vendimit të Kushtetueses, deklaroi hapur se "të gjithë duhet ta respektojnë vendimin e gjykatës dhe duhet të përbahen dhe qëndrojnë larg dhunës". Këto deklarata janë pasuar nga krejt faktorët relevantë të politikës ndërkombëtare të përfshirë në cështien e Kosovës.

çështjen e Kosovës. Kështu që LV-së i mbeti të gjiejë metoda të “revolucioneve të vonuara demokratike” për ta bërë politikën kundërshtuese, gjë që e pres që Albini edhe më tej, duke mbetur jashtë Kuvendit, do ta krijojë kabinetin në selinë e partisë dhe do të tentojë ta bllokojë punën e qeverisë dhe Kuvendit përmes të gjitha mundësive që i jepen, në

mënyrë që sa më shpejt ta bindë botën dhe shqiptarët se edhe kjo qeveri po dështon në vendimmarjet e rëndësishme dhe se vendi duhet të shkojë në zgjedhje. Pra, edhe më tutje jam i mendimit se jo përmes revoltave me "gjakderdhje", Albini do ta përbysë qeverinë

Precedenti pozitiv juridik i
Giykatës Kushtetuese

LV-ja gjatë qeverisjes së Republikës së Kosovës dy herë kishte shkelur Kushtetutën, me vendimet e kufizimit të të drejtave të lëvizjes së lirë të shtetasve të saj, ndërsa në kontestim me dekretin presidencial, LV-ja e dërgoi në kushtetuese atë jo për të fituar ndaj dekretit, por për të fituar kundër Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe t'i mbivendosjej.

Ndërsa vendimi i gjykatës në pikëpamjen time është precedan në kontekst pozitiv ngaqë LV-në arriti ta disiplinojë dhe ta detyrojë që nga një lëvizje anarkiste-neokomuniste me zëdhënës kontrovers (siç i kujtojmë thirrjet e Agim Bahtirit, avokatit Tomë Gashi, deklarimet publike e zyrtare të liderëve drejtues të subjektit dhe në qeveri et.j) që me fjalor nxitës po tentonin t'i shtynin qytetarët në përplasje civile e gjakderdhje. Mençuria dhe arsyetimi i Gjykatës, duke mos lënë asnijë hapësirë për dykuptimësi, preciziteti i lartë në interpretimin juridik dhe fryma shtetërore e një republike parlamentare, u vulosën përmes vendimit të saj dhe në këtë konstelacion, ky vendim përbën precedentin pozitiv juridik në praktikat e gjykatave kushtetuese në botë, për çka duhen përgjegzuar gjyqtarët e saj, si gardianët e Republikës së

Kosovës jo vetëm në këtë rast. Me këtë do të vendosen norma të sjelljes me kulturë institucionale dhe shtetformuese, nuk do të lejohet më vendosja e hegemonisë personale apo konjukturale të asnje individi, subjekti apo grupimi politik. Të fituarit e zgjedhjeve, apo qenia parti e parë, nuk do të thotë mbivendosje ndaj kushtetutshmërisë në aspektin procedural ligjor dhe të funksionimit të institucioneve shtetërore. Praktika sfidon teoritë sado të avancuara të jenë si doktrina zhvillimore. Ndaj Gjykata Kushtetuese tashmë e ka shtuar rolin juridik si gardiane e kushtetutshmërisë dhe demokracisë parlamentare në vendin tonë.

Pritjet nga geveria Hoti

Qeveria Hoti i mori votat indikative, të nevojshme për fillimin e mandatit dhe sot formalisht filloj punën. Zotëri Hotin në kujtesën qeverisëse kujtohet si ministri që vuri disiplinën financiare gjatë qeverisjes Mustafa/Thaçi. Ai paraqiti katër objektiva parësore të qeverisë:

1. Pandeminë e cila po vazhdon;
2. Ringritjen ekonomike post-pandemi;
3. Reformën elektorale dhe reformën në drejtësi; dhe
4. Bisedimet me Serbinë.

A do t'i arrijë objektivat
dhe sa përballon
kjo qeveri?

Së pari vështirësi më të madhe se pandemja, korrupsiioni dhe opozitarizmi i Albinit, duhet parë situatën në të cilën aktualisht ndodhet Amerika. Kriza politike dhe e sigurisë që po kalon ShBA-ja paraqet krizë të madhe edhe në Republikën e Kosovës. Kjo e vështirëson fillimi i tërë përpjekjen, akoma më keq, sepse kjo krizë paraqet krizën nëpër të cilën po kalon Partia Republikane në ShBA. Nga përvojat e së kaluarës, kur republikanët janë në disavantazh, ngritën ekstremet e majta nëpër botë dhe këto majtizma cenojnë ekzistencën e kombit shqiptarë nëpër shtetet e ndryshme ku kombi shqiptar shtrihet. Vështirësia kundër pandemisë dhe ringritja ekonomike nuk janë telashe për këtë qeveri, por janë bisedimet

me Serbinë, ngaqë kjo temë ka rrëzuar tri qeveri deri tani. Me stabilizimin e situatës në ShBA bisedimet serbo-kosovare duhet të rifillojnë shumë shpejt. Në këtë fazë bisedimet do të jenë tepër të rënda, por përcaktuese, ndaj pritet se kjo qeveri do ta nënshkruajë marrëveshjen përfundimtare, me theks miratimin e saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Edhe partive opozitare do t'u përshtatet të mbërrijnë në fundin e këtij kapitulli.

Çfarë do të qëndrojë në themel të ujdisë serbo-kosovare?

Krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, sipas rekomandimeve të Gjykatës kushtetuese, do të jetë themeli i arritjes së ujdisë me Serbinë. Lëvizja e kufijve si temë do të ishte e dëshirueshme sikur t'i krijohej Kosovës mundësia takimit nën administrim edhe Sanxhakun edhe Kosovën Lindore, me këtë edhe standartet e "Pakos së Ahtisarit" përmes së cilës në do të garantonim të drejtat e pakicës serbe në Kosovë. Që nga viti 1999 Republika e Kosovës si shtet i ka

Republika e Kosovës si shitet i kataloguar Botës se nuk i shkel të drejtat e askujt. Asnjë serb nuk është burgosur në Kosovën e pas luftës pse është anëtar i ndonjë partie serbe, në asnjë palezgjedhje partitë serbe nuk janë diskriminuar. Kuvendi i Kosovës kurrë nuk ka sjellë propozimligje për ndaljen e investimeve në komuna serbe. Decentralizimi dhe formimi i komunave ua ka lehtësuar jetën pakicës serbe në Kosovë, përfshirja në Polici dhe FAK si dhe mjetet e informimit në gjuhën serbe si TV dhe media të tjera, janë treguesit më të mirë se komuniteti serb brenda shtetit të Kosovës jeton më mirë se kudo tjetër. Prandaj, sikur bota të donte do të duhej t'i ndreqte padrejtësitë historike, që pas "luftërave ballkanike", posaçërisht pas Luftës se Dytë Botërore t'i kornizonte tokatona.

Ne garantojmë se nuk i dëbojmë serbët nga Sanxhaku as nga cilido qytet i Kosovës, por do t'i garantonim liritë dhe të drejtat e njeriut sipas konventave të të drejtave të pakicave dhe bazuar në "Pakon e Ahtisarit". Pra, të gjitha këto janë një arsy e mirë që Kosovës t'i kthehet Kosova

Lindore dhe Sanxhaku. Kurse shkëmbimi i territoreve nuk mund të ndodhë. Në Kosovë nuk ka tokë serbe. Nuk kemi çka i japim askujt! (Bosnja, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia Veriut dhe Greqia kanë toka shqiptare në zotërim/okupim. Ndaj kjo duhet diskutuar shpejt besoj, në një kostelacion të ri botërор.

Sjellja e PDK-së ndaj qeverisë?

PDK-ja ka treguar se ashtu siç ishte mbrojtësja e shtetit dhe kushtetutshmërisë kur ishte në qeverisje, do të jetë edhe tanj kur është në opozitë. PDK-ja nuk do ta mbështesë asnjë propozim a vendim që rrezikon shtetin e Kosovës, nuk bën pazare për qeveritë, por bën politikë shtetërore. E tillë pritet të mbetet edhe më tej. Besoj shumë se qeveria Hoti do t'i krijojë opozitës më shumë hapësirë konsultimi dhe krijimi të politikave shtetërore qoftë përmes grupeve parlamentare, qoftë përmes ngritjes së trupave të përkohshme qeveritare për çështje të caktuara. PDK-ja do të jetë përherë mburoja e sovranitetit dhe kushtetutshmërisë së Kosovës.

Presidenti Thaçi në krizën institucionale

Reforma elektorale në Kosovë duhet të ndodhë. Nuk mund të pritet shpejt që Kosova të kalojë në shtet presidencial, se duhet përcjellë me shumë ndryshime kushtetuese që e përcaktojnë formën e regjimit, por jam i sigurt se Hashim Thaçi nuk do t'i imponohet kurrë kombit shqiptar si lider ose president i kulisave politike. Jam i sigurt se do të jetë president i vullnetit politik kombëtar, i shprehur lirshëm në çfarëdo forme zgjedhore. Dy mandate presidenciale të z. Hashim Thaçi unë mendoj se Republikën e Kosovës do ta stabilizojnë si shtet qoftë në raportet ndërkombe, në aspektin integruesh, qoftë në rrafshin e stabilitetit të politikave të brendshme. Kosovës i duhet edhe për një kohë një personalitet me peshë politike dhe me të kaluar politike e cila i lidhë të gjitha etapat nëpër të cilat kaloi Kosova si shtet, që nga shpallja përmes Kushtetutës së Kaçanikut e derisa të anëtarësohet në NATO.

Vetëm në katër muajt e parë të këtij viti regjistrohen mbi 37 mijë punëkërkues në Kosovë

Instituti GAP ka publikuar të dielën raportin në lidhje me ndikimin e pandemisë Covid-19 në tregun e punës së Kosovës. GAP-i ka bërë me dije se vetëm në katër muajt e parë të këtij viti në Agjencinë e Punësimit janë regjistruar mbi 37 mijë punëkërkues. Një pjesë e madhe e tyre (16 820) janë gra. "Marrë parasysh pjesëmarjen shumë të ulët të aktivitetit ekonomik të grave dhe barrierat e tjera në punësim, shkalla e papunësisë në mesin e grave mund të rritet edhe më shumë", ka njoftuar GAP-i.

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Instituti GAP ka analizuar ndikimin e hershëm të pandemisë Covid-19 në tregun e punës si dhe ndikimin e masave intervenuese të qeverisë në zbutjen e rreziqeve të papunësisë, duke publikuar edhe një raport. Sipas këtij rapporti, përhapja e pandemisë në Kosovë, e shoqëruar me kufizimin e lëvizjes së qytatarëve dhe mbylljen e shumë veprimitarive afariste, ka pasur një ndikim të menjëhershëm në tregun e

punës. Sipas GAP-it, gjatë kësaj periudhe në Agjencinë e Punësimit janë regjistruar mbi 37 mijë punëkërkues. "Vetëm në muajin prill janë regjistruar gjithsej 32 377 punëkërkues të rinj, duke bërë që numri i përgjithshëm i punëkërkuesve në Agjencinë e Punësimit të shkojë në 37 392 në katër muajt e parë të vitit 2020. Një pjesë e madhe e tyre (16 820) janë gra. Marrë parasysh pjesëmarjen shumë të ulët të aktivitetit ekonomik të grave dhe barrierat e tjera në punësim, shkalla e papunësisë në mesin e grave mund të rritet edhe më shumë",

ka njoftuar GAP-i. Më tutje, GAP-i ka theksuar se të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) kanë treguar se industritë të cilat punësojnë më së shumti punëtorë në Kosovë, ajo e tregtisë me shumicë e pakicë, e ndërtimtarisë dhe industrisë përpunuese, kanë shënuar rënien të madhe të punëtorëve gjatë periudhës janar-mars 2020. "Përderisa në mars të vitit 2019 në industriin e tregtisë me shumicë e pakicë punonin rreth 80 mijë persona, në mars 2020 ky numri ra në rreth 43 mijë. Edhe numri i kontributpaguesve në



Fondin Pensional të Kosovës (Trust) ka shënuar ulje rrëth 20 për qind në shumicën e komunave të Kosovës", ka njoftuar Instituti GAP. Me gjithë lehtësimin e masave kufizuese dhe hapjen graduale të veprimtarive biznesore, GAP-i ka ardhur në përfundim se tregu i punës nuk mund të kthehet menjëherë në situatën e parapandemisë. "Kjo për shkak se jo të gjitha veprimtaritë

ekonomike që do të hapen do ta kenë kërkesën e njëjtë për ofrim të mallrave apo shërbimeve si dhe për shkak se bota e pas-pandemisë mund të kërkojë veprimtari dhe shërbime të reja ekonomike të cilat kërkojnë edhe shkathtësi të reja. Andaj, pa një plan gjithëpërfshirës të rimëkëmbjes ekonomike numri i të papunëve mund të rritet edhe më shumë në muajt në vijim", ka njoftuar GAP-i.

Zeka: Pasojat e pandemisë në ekonomi do të vërehen edhe në vitin 2021

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Rimëkëmbja ekonomike pas përfundimit të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi do të jetë sfidë për Kosovën nëse nuk ndërhyrë shteti brenda dhjetë ditësh. Kështu ka thënë kryetari i Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës, Arian Zeka.

Zeka në një intervistë për "Ekonomia Online" ka thënë se qeveria në krye me Avdullah Hotin duhet të merret me urgjencë me aprovin e programit gjithëpërfshirës të rimëkëmbjes ekonomike. "Qeveria e re duhet të merret me urgjencë me hartimin dhe sigurimin e aprovimit nga ana e Kuvendit të një programi gjithëpërfshirës të rimëkëmbjes ekonomike, duke e ditur ndikimin tejet negativ që ka pasur pandemia Covid-19 në sektorin privat në veçanti dhe ekonominë e vendit në përgjithësi. Nga ekspozeja e kryeministrit Hoti, ditën kur e



rezantoi kabinetin qeveritar, realisht reflektonin disa prej atyre që kanë qenë edhe rekomandime të Odës Ekonomike Amerikane, por edhe të Asociacionit të Biznesit. Kjo është inkurajuese. Plani i propozuar ishte ambicioz, por nuk është diçka që nuk mund të realizohet. Me rëndësi është që të ketë një proces gjithëpërfshirës të dialogimit para aprovimit të tij. Ky program duhet të hartohet brenda dhjetë

ditësh, megjithatë ekziston një bazë solide e rekomandimeve që janë dhënë nga ne dhe kjo do të duhej që ta lehtësonte punën", ka thënë Zeka. Sipas kreut të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, shifra prej 1 miliard eurosh e propozuar nga Avdullah Hoti, përmobilizimin e zbatimit të Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike, është duke u parë si e realizueshme nga Zeka. Megjithatë, ka thënë se e

rëndësishme është të ndodhë. "Unë besoj se do të jetë e realizueshme. Shifra korrespondon pak a shumë me atë që është prezantuar në atë draft-programin e rimëkëmbjes së qeverisë së kaluar. Nuk e dinë se do të ndihmojë në adresimin proporcional të dëmeve, megjithatë ajo çfarë tha kryeministri Hoti është që kjo pako e rimëkëmbjes do të pasojë një vlerësim të ndikimit që pandemia ka pasur në ekonomi. Besoj se kjo është e rëndësishme të ndodhë. Po ashtu, kemi të dhëna zyrtare nga ATK-ja që tregojnë për një rënien të qarkullimit në rrëth 45 për qind, që korrespondon me atë që ne si OEAK e kemi thënë vazhdilimisht, që ndikimi i pandemisë ka qenë në normën deri në 50 për qind", është shprehur Zeka. Teksa ka folur për pasojat që ka lënë kjo pandemi, Zeka ka thënë se dëmet do të vërehen pashmangshëm edhe përgjatë

vitit 2021. "Pashmangshëm që efektet dhe pasojat e pandemisë në ekonomi do të vërehen edhe përgjatë vitit 2021, ndoshta jo për tërë vitin, por në një pjesë të konsiderueshme të muajve të parë. Një parashikim i mëhershëm i Bankës Botërore thoshte që nëse pandemia merr fund, pastaj rikuperimi i plotë mund të arrihet brenda 2021. Gjithmonë duhet ta kemi në konsideratë që ne kemi qenë më të vonshëm dhe nuk kemi ofruar reagimin adekuat në atë që ka qenë faza emergjente e pandemisë dhe sot e kësaj dite vazhdojmë të marrim ankesa nga ana bizneset për mos disbursimin e mjeteve të parapara në masat e pakos emergjente fiskale. Po flas përkompensimin e pagave dhe shpenzimet operacionale, gjegjësisht të qirave, të cilat ende nuk kanë janë kryer", ka deklaruar Zeka.

Muharremaj: Pandemia dëmtoi bizneset në Suharekë

Suharekë, 7 qershor - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka deklaruar se pandemia Covid-19 ka dëmtuar shumë biznese dhe ka penguar aktivitetin e tyre. Muharremaj është shprehur i bindur se ato së shpejti do të rimëkëmben. Sipas tij, edhe pas lehtësimit të masave kjo komunë ka zbatuar të gjitha vendimet e qeverisë. "Komuna e Suharekës ka shumë biznese

të forta. Është e vërtetë se pandemia i ka penguar dhe dëmtuar. Besoj se do t'i marrin shumë shpejt këmbët. Komuna e Suharekës dhe firmat do të dalin të punojnë dhe kanë filluar të punojnë. Humbjet i kemi si çdo komunë tjetër", ka thënë Muharremaj. Në pikëpyetje, sipas tij, është mundësia e ndihmesës përbizneset nga Komuna e Suharekës pasi, sipas të parit

të kësaj komune, të hyrat janë të ulëta për këta tre muaj. "Po presim të përfundojë edhe faza e tretë. Do të ulemi me shefat e grupeve parlamentare e të bisedojmë përti parë mundësitë e bashkëpunimit me shefat e grupeve të të gjitha partive politike. Ne kemi filluar detyrat në terren, për realizim të projekteve, kështu që do të kemi probleme sa i përket buxhetit, pasi që në muajin mars janë mbledhur vetëm 12 mijë e në muajin prill 15 mijë euro. Kanë qenë të planifikuar 220 mijë euro në vit", është shprehur Muharremaj përk "Kosovapress".

Pandemia Covid-19 zvogëlon të hyrat tatimore në Kosovë

Ilir Murtazaj, drejtor i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), ka thënë se në pesëmujorin e parë të këtij viti ka pasur rënie të të hyrave nga tatimet. Nga muaji janar e deri në muajin maj të hyrat në ATK kanë qenë mbi 186 milionë euro apo 22 milionë euro më pak, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. “Periudha për pagesa të detyrimeve tatimore dhe kontribute pensionale është zgjatur deri më 15 maj 2020, si dhe pagesa e kësteve tremujore është zgjatur deri më 30 qershor 2020”, ka thënë Murtezaj

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Masat që Kosova ka ndërmarrë në muajin mars për parandalimin e përhapjes së koronavirusit, siç janë kufizimet në ushtrimin e aktiviteteve ekonomike, shlyerja dhe shtyrja e obligimeve tatimore ka ndikuar në uljen e të hyrave në Administratën Tatimore Kosovës (ATK).

Një nga bizneset që pas marrjes së vendimit të qeverisë nuk ka paguar një pjesë të tatimit eshtë kompania "Pestova" nga Vushtrria. Pronari i kësaj kompanie, Bedri Kosumi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se në muajin e parë ka shfrytëzuar vendimet e qeverisë, por tashmë eshtë i rregullt në përfundimin e detyrimeve ndaj Administratës, edhe pse thotë ai, kompania "Pestova" ka pasur vështirësi financiare gjatë masave kufizuese. Madje

Kosumi ka treguar se për t'u përballuar me situatën financiare dhe krijimin e linjave të reja prodhuese ka marrë kredi në një nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë. "Në fillim të pandemisë kemi shfrytëzuar ato shtyrjet e deklarimeve dhe për pagesa të tatimeve për një muaj, mandej jo. Kemi pasur probleme shumë sikurse të gjitha bizneset në Kosovë dhe më gjerë, por më pas kemi qenë në gjendje më të mirë dhe i kemi paguar obligimet rregullisht. Kredia është marrë edhe për linjën prodhuese dhe ruajtjen e likuiditet, zvogëlimin e parasë së gatshme për t'i mbuluar vitet e ardhshme", ka thënë Kosumi. Ndërsa Ilir Murtazaj, drejtor i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), ka thënë se në pesëmujorin e parë të këtij viti ka pasur rënje të të hyrave nga



tatimet. Nga muaji janar e deri në muajin maj të hyrat në Administratë kanë qenë mbi 186 milionë euro apo 22 milionë euro më pak kahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. “Njëkohësisht janë edhe vendimet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve, pasi periudha për pagesa të detyrimeve tatumore dhen kontribute pensionale është zgjatur deri më 15 maj 2020 si dhe pagesa e kësteve tremujore është zgjatur deri më 30 qershor 2020”, ka thënë ai.

Rënien e inkasimit të të hyrave Murtezaj e ka ndërlidhur edhe me rënien e qarkullimit të bizneseve. Sipas të dhënave të ATK-së për muajin prill, rreth 44

për qind kanë pësuar rënien të qarkullimit bizneset krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Edhe Bedri Kosumi nga kompania "Pestova" ka treguar se gjatë kësaj periudhe kanë pasur rënien të qarkullimit. "Në muajin mars kemi pasur 12 për qind rënien, në prill më tepër se 20 për qind dhe në muajin maj 8 për qind rënien", ka theksuar Kosumi.

Vendimet e Qeverisë së Kosovës për parandalimin e pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi, do të ndikojnë edhe në projekcionet e planifikuar vjetore, ka thënë Murtezaj. Sipas projekioneve të paraqitura në buxhetin e miratuar në mars të këtij viti, është paraparë që ATK-

ja të mbledhë 557 milionë euro. Por, sipas Murtezajt, kjo shifër është vështirë e realizueshme. "Në Administratën Tatimore, edhe pse është herët ta parashikojmë fundin e vitit, sipas parashikimeve të brendshme të ATK-së, synojmë që të arrijmë deri te niveli i realizimit të të hyrave tatimore të vitit të kaluar, që nënkupton se, edhe pse mund të kemi një rënie të ekonomisë, të paktën duke zvogëluar evazionin fiskal të arrijmë te niveli i realizimit të të hyrave të vitit të kaluar", ka thënë Murtezaj. Vitin e kaluar Administrata Tatimore e Kosovës, sipas Murtezajt, ka arritur të grumbullojë 504 milionë euro.

PDK-ja sjell dhjetë propozime për Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike



Bankës Botërore, duke i zhytur rrëth 150 mijë qytetare në varfëri. Në mungesë të një plani efikas e konkret, qeveria Kurti, e përbërë nga LV-ja dhe LDK-ja, ofruan një pakem emergjente financiare më të varfër në rajon - prej 179 milionë eurosh, ku në praktikë u realizua vetëm 30 për qind", ka thënë Totaj, duke shtuar se shumica e vendeve të rajonit dhe botës kanë miratuar pakon e dytë gjithëpërfshirëse përimëkëmbien ekonomike. "Si

rezultat i keqmenaxhimit, shteti i Kosovës duhet të jetë i gatshëm që t'i ndajë mbi 1.5 miliard euro për rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit. Andaj, ne ftojmë qeverinë e re që sa më parë t'i propozojë Kuvendit të Republikës së Kosovës planin me masat konkrete për rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit. Propozimi, në thelb, duhet ta ketë interesin e të gjithë të punësuarve në sektorin privat, bizneset dhe të gjitha skemat sociale pa dallime.

Sidomos duan përkrahje bizneset e mesme dhe të vogla që për shkak të masave kundër pandemisë, sot rrezikojnë të falimentojnë", ka thënë Totaj. Për ta rikthyer stabilitetin makro-ekonomik dhe për t'i ndalur humbjet për sektorin privat, Totaj ka thënë se është me rëndësi që propozimi i qeverisë së re t'i ketë këto elemente thelbësore në periudhën afat-shkurtër: Të jetë në përputhje me nevojat e vërteta të ekonomisë së tregut, duke stimuluar likuiditetin e ndërmarrjeve dhe shtimin e aktivitetit ekonomik; të jetë lehtë i zbatueshëm dhe në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi; të jetë i fokusuar në ndihmën e ndërmarrjeve që kanë rrezikshëmëri të lartë përfalimentim, sipas vlerësimit të Bankës Botërore; të ketë përbazë barrën financiare që kanë sektori privat dhe punëtorët e saj tek institucionet financiare, duke ofruar mundësi mbështetje të drejtëpërdrejtë për uljen e harrës

Ka filluar pastrimi i Liqenit Akumulues në Mitrovicë

MITROVICË, 7 QERSHOR (ER) - Komuna e Mitrovicës ka filluar aksionin për pastrimin e liqenit akumulues të lumi Ibër në Suhadoll të kësaj komune. Ky aksion është ndërmarrë me iniciativën e kryetarit të komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, në bashkëpunim me Shoqatën e Peshkatarëve Sportivë Rekreativë (SHPSR) "Ibri" dhe KRM "Uniteti", në të cilin janë bashkangjitur edhe kompanitë "Ambienti", "Euro Ndërtimi",

Klubi i Zhytjes "Trepça" dhe një numër simbolik i qytetarëve vullnetarë. Me këtë rast, kryetari Bahtiri u shpreh tejet falënderues nga Shoqata e Peshkatarëve, KRM "UNITETI", kompanitë e tjera në fjalë dhe të gjithë qytetarët e tjerë të cilët iu bashkëngjitet këtij aksioni, me qëllim që të pastrohen hapësirat ujore nga barishtet. Po ashtu, kryetari Bahtiri ka bërë me dije se ky aksion është zhvilluar nga vullneti i mirë i përbashkët

dhe se në programin e tij qeverisës ka paraparë edhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të këtij liqeni, mirëpo për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 është bërë e pamundur shpallja e tenderit për blerjen e makinës adekuate për pastrimin e Liqenit. Dhe për këtë gjë komuna ka ndarë mjetet e nevojshme, me ç'rast shumë shpejt do të pajisemi me këtë makinë dhe do të kemi një liqen mjaft të pastër.



Komuna e Skenderajt, shembull për mirëmenaxhimin e parasë publike edhe në kohë të pandemisë

SKENDERAJ, 7 QERSHOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se gjatë kohës së pandemisë Covid-19 ka blerë shërbime me çmimet më të lira, duke dëshmuar kështu menaxhim efikas të situatës pandemike. "Ky raport është nxjerr nga organizata INPO, e cila ka publikuar dy infografika rreth shpenzimeve komunale gjatë pandemisë Covid-19. Në infografika paraqiten shpenzimet e komunave gjatë blerjes së shërbimeve dhe artikujve si masë mbrojtëse ndaj kësaj

pandemie. Sipas këtij hulumtimi, Komuna e Skenderajt ka pasur çmimet më të lira të blerjes së produkteve në këtë gjendje emergjente", ka njoftuar Komuna e Skenderajt. Sipas këtij njoftimi, gjatë kësaj periudhe Komuna e Skenderajt ka qëndruar afër familjeve në nevojë ku për dy herë radhazi ka ndihmuar me pakë ushqimore 4 000 familje në nevojë. "Krahas kësaj, i është kushtuar kujdes edhe kursimit të parasë publike duke mos lejuar që biz-

neset e caktuara t'i rrisin në mënyrë artificiale çmimet e produkteve që kanë pasur nevojë t'i sigurojnë qytetarët", ka njoftuar kjo komunë, duke cituar edhe kryetarin Bekim Jashari në lidhje me menaxhimin e parasë publike. "Kur ka vullnet politik dhe përkushtim për punë në dobi të mirëqeverisjes e mirëmenaxhimit të parasë publike mund të arrijmë që t'i ndihmojmë familjet në nevojë dhe atë duke ruajtur buxhetin komunal", është shprehur Jashari.

Lladrovci përkujton dëshmorët Hasan e Xhavit Hasani

DRENAS, 7 qershori (ER) - Me rastin e 21-vjetorit të rënies së dy dëshmorëve, Hasan e Xhavit Hasani, kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka bërë homazhe dhe kanë vënë buqeta me lule të freskëta pranë lapidarit të dëshmorëve në Korroticë e Ulët. Me këtë rast, kryetari Lladrovci ka thënë se pa luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlir-



intare të Kosovës dhe sakrificën e gjithë të rënëve nuk do të vinin liria dhe pavarësia e Kosovës. "Lavdi e përjetshme gjithë të rënëve!", ka thënë Lladrovci.

Aksident i rëndë në Drenas, lëndohen disa persona

DRENAS, 7 QERSHOR (ER) - Në fshatin Zabel i Ulët i Komunës së Drenasit të dielën ka ndodhur një aksident i rëndë. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, nëpërmjet llogarisë se vet në "Facebook" ka njoftuar se në këtë aksident janë lënduar disa persona, por asnjëri prej tyre nuk është në rrezik për jetën. Aksidenti në Zabel të Ulët tregon shumë përmungesën e kujdesit në komunikacion. Pandeminë e përballet si duhet, kujdesi për jetën tonë dhe të tjerëve nuk duhet të mungojë asnjëherë!", ka shkruar Lladrovci.

Filloi ndërtimi i objektit të shkollës 'Habib Berisha' në Gurbardh

MALISHEVË, 7 QERSHOR (ER) - Në vigjilje të shënimit të 16 Qershorit, Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimtës së Malishevës, në fshatin Gurbardh ka filluar ndërtimi i objektit të ri të shkollës, e cila mban emrin e dëshmorit të komunitatit Habib Berisha. Betonin e parë në themelët e kësaj shkolle e ka vënë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Në vënien e gurthemelit të objektit të shkollës kanë marrë pjesë familjarë të dëshmorëve të komunitatit nga fshati Gurbardh, Habib e Hamdi Berisha, nën kryetari i Malishevës, Hajdin Berisha, drej-

tori i Drejtorisë së Arsimit, Blerim Thaçi, drejtore të drejtoreve të tjera komunale, menaxhmenti dhe arsimtarët e kësaj shkolle dhe banorë të fshatit. "Ne po ndërtojmë këtë shkollë, sikur edhe shkollat e tjera, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira përmësimdhënie dhe mësimdhënie, ndërsa e juaja mësimdhënës është që t'u jepni dije sa më shumë nxënësve, ta rrissni cilësinë në arsim. Kjo shkollë mban emrin e madh të dëshmorit Habib



Berisha dhe të gjithë ne jemi krenarë por, krahas krenarisë, ne duhet të punojmë edhe më shumë në rritje të cilësisë në

arsim dhe me rezultate korekte, sepse dëshmorët kanë dhënë jetën për këtë, që ne sot të jetojmë të lirë dhe të punojmë përmes arsimimit", ka thënë kryetari Begaj. Ndërsa nën kryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka thënë se "ndërtimi i kësaj shkolla po fillon në vigjilje të shënimit të 16 Qershorit - Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimtës së Malishevës, pasi tashmë ka filluar ndërtimi i objektit të ri të shkollës sipas standardeve.

RIKUJTESË ÇLIRIMTARE



Ismet
SYLEJMANI


Sot më 7 Qershori 2020, bëhen 21 vite që kur e kam lëshuar informatën zyrtare për opinion nga Sherbimi për Informim Publik i Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së, të derguar në Radio Televizionin Shqiptar, dhe të lexuar drejtëpërdrejtë në TVSH, nga Selia e Shtabit të Zonës nga lagjja malore Srpka, e Kishnapoles, ku ishim te vendosur!

Në shenjë kujtimi e respektit, lavdie e nderimi për Heronjte dhe Deshmorët e Kombit, për shokët dhe bashkëluftëtarët, për popullin shqiptarë dhe luftën heroike çlirimtare e për Kosvën legjendare e të panënshtuar në shekuj, sot në përvjetorin e 21-të, të daljes në dritë të këtij dokumenti e risjell për mbarë opinionin kombëtar e ndërkomëtar INFORMATËN e ZOK të UÇK-së!

**LAVDI HERONJËVE DHE DËSHMORËVE TË KOMBIT!
LAVDI USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS!**

Ish-Shef për Informim i Zonës Operative të Karadakut-ZOK të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës-UÇK-së!

Gjilan, më 7 Qershori 2020!



USHTRIA CLIRIMTARE E KOSOVËS
Zona Operative e Karadakut

INFORMATË
Për TVSH-në

Në Zonën Operative të Karadakut ashtu si edhe më parë ekziston gjendje e tensionuar.

Forcat serbe janë të përqëndruara përgjatë tërë pikave më strategjike të katër komunave që perfshinë Zona Jonë. Nuk ka tërheqje të forcave serbe, por perkundrazi, ka koncentrim akoma më të madh.

Në Gjilan ende mbahen në burg 15-të persona nga 36 sa ishin të arrestuar.

Si kundër përgjigje e dhunës dhe presionit ushtaraku-politic serb, njësitët tona po kryejnë vepime luftarake në tërë Zonën. Kështu mbrëmë më 06.06.'99 rreth orës 20:45 minuta njësitët gueril i Batalionit të I-rë "Pajazit Ahmeti-Paja" i Brigades 171 "Kadri Zeka" të Zonës Operative të Karadakut, ka kryer aksion të suksesshëm duke asgjësuar një bandë kriminelësh në f.s.h. Zhegoc i Epërm komuna e Gjilanit. Banda çetnike serbe e përbërë prej 5 vetash, nga ushtarë të rregullt e paramilitarë, e prirë nga eprori aktiv Dragan Sreten Millosheviq i datlindjës 20. tetor 1975 në Aleksinac, me t'u kthyer nga plaçka në vendin e quajtur Hanet afër varrezave, aty ku pushon trupi i deshmorit të Atdheut e të Ushtrisë sonë Çlirimtare Alban AJETI, u goditën përvdekje dhe iu morr i tërë armatimi.

Krismat e pushkëve të luftëtarëve të lirisë mbi armiq, aty afër varrit të dëshmorit, ishin përshtedjetje e nderë i jashtëzakonshëm për trimin dhe realizim i betimit të shokëve për hakmarrje.

Njësiti u kthye në bazë pa humbje.

07.06.1999

Sherbimi për Informim Publik
i Zonës Operative të Karadakut

Sokol GASHI

USHTRIA CLIRIMTARE E KOSOVËS
Zona Operative e Karadakut

INFORMATË
Për TVSH-në

Në Zonën Operative të Karadakut ashtu si edhe më parë ekziston gjendje e tensionuar.

Forcat serbe janë të përqëndruara përgjatë tërë pikave më strategjike të katër komunave që perfshinë Zona Jonë. Nuk ka tërheqje të forcave serbe, por perkundrazi, ka koncentrim akoma më të madh.

Në Gjilan ende mbahen në burg 15-të persona nga 36 sa ishin të arrestuar.

Si kundër përgjigje e dhunës dhe presionit ushtaraku-politic serb, njësitët tona po kryejnë vepime luftarake në tërë Zonën. Kështu mbrëmë më 06.06.1999 rreth orës 20:45 minuta njësitët gueril i Batalionit të I-rë "Pajazit Ahmeti-Paja" i Brigades 171 "Kadri Zeka" të Zonës Operative të Karadakut, ka kryer aksion të suksesshëm duke asgjësuar një bandë kriminelësh në f.s.h. Zhegoc i Epërm komuna e Gjilanit. Banda çetnike serbe e përbërë prej 5 vetash, nga ushtarë të rregullt e paramilitarë, e prirë nga eprori aktiv Dragan Sreten Millosheviq i datlindjës 20. tetor 1975 në Aleksinac, me t'u kthyer nga plaçka në vendin e quajtur Hanet afër varrezave, aty ku pushon trupi i deshmorit të Atdheut e të Ushtrisë sonë Çlirimtare Alban AJETI, u goditën përvdekje dhe iu morr i tërë armatimi.

Krismat e pushkëve të luftëtarëve të lirisë mbi armiq, aty afër varrit të dëshmorit, ishin përshtedjetje e nderë i jashtëzakonshëm për trimin dhe realizim i betimit të shokëve për hakmarrje.

Njësiti u kthye në bazë pa humbje.
07.06.1999

Shërbimi për Informim Publik i Zonës Operative të Karadakut
Sokol GASHI

Trinomi që mban peng shqiptarët: Rozafa, Avni Rustemi dhe Esat Pasha



Agron SHALA

Gjatë Krizës së Madhe Ekonomike në vitet '20 të shekullit të kaluar, supat falas për të varfrat e Çikagos në ShBA, bënë që një kriminel famëkeq si Al Capone të perceptohet nga turmat si humanist. 60 vjet më vonë, Pablo Escobari u bë hero i lagjeve të varfra të Medellinit të Kolumbisë.

Rastet e tillë tregojnë se në kohë krizash ka edhe kaos vlerash, andaj ndodhin perceptimet e gabuara për të mirën e për të keqen. Historia e njerëzimit njeh shumë shembuj të tillë. Vlen të përmendet rasti i një prej heronjve më të mëdhenj të kinematografisë, Robin Hoodit. Ai është simbol i drejtësisë; është hero që vjedh nga të pasurit e u ndihmon të varfërve; është fisniku i drejtë anglez që kundërshton rendin që e imponon një sundimtar i keq e usurpator – mbreti John; është zëri i popullit, shpresë... Por, e vërteta është se është pikërisht

Johni i "keq" ai që e miratoi dokumentin e famshëm Magna Carta, që vlerësohet si boshti i demokracisë moderne. E, Robin Hoodi nuk ishte fisnik, por një çoban dhe kriminel ordiner si Capone apo Escobari.

Përderisa miti i Hoodit, Capones apo Escobarit janë brumë i mirë veç për kinematografi, të tre këta nuk janë modele që i aplikojnë ShBA-ja, Anglia apo edhe Kolumbia (një popull, po ashtu, me nivel shumë të lartë të artit e të kulturës). Sepse shteti dhe e ardhmja nuk bazohen në gjenjeshtra.

Në anën tjetër, e tëra që u thuhet shqiptarëve është se ishin të mirë, se askënd nuk e kanë sulmuar, se janë i vetmi popull që nuk ka bërë kurrë luftëra pushtuese, ama se ishin fort fatkeq: përherë të rrëthuar me armiq e të nëpërkëmbur. Ishin pra viktima, dhe viktimizimi fatkeqësish u bë vlerë.

Kjo mendësi fillesat i ka te miti i Rozafës, tek ai rrëfimi për tre vëllezërit e martuar që ndërtonin një kala, por puna që bënin ditën u prishej natën. Krejt kjo derisa një ditë një plak u thotë ta lidhin besën dhe të mos përgojojnë këtë që do t'ua thotë: nusja që ditën tjetër ua dërgon ushqimin, duhet të muroset e gjallë në kala. Dy vëllezërit e mëdhenj

paralajmërojnë gratë, por jo edhe i vogli që, mbapse, besonte se fati përcaktohet nga një fuqi e panjohur. Rozafa muroset dhe e lë jetim djalin e vogël.

Pra, miti i viktimidit të Rozafës ndërlidhet me tradhti dhe besimin e verbër. Dhe, ky lloj viktimidit, kjo sakrifice "për të mirën", edhe sot perceptohet si vlerë, si virtuty që duhet ndjekur. E, për ta mbështetur ndërtimin e "Kalanë" (marrjen e mbajtjen e pushtetit), modelet kërkohen kudo. Por, më i keqi është ai i Avni Rustemit që përmendet sa herë që dikujt i rrezikohet "Kalaja".

Emri i Avni Rustemit ndërlidhet me emrin e Esat pashë Toptanit. I pari merret si patriot i padiskutueshëm, i dyti si tradhtari i padiskutueshëm. Të dy emrat përdoren sa herë që nxitet ndarja në "ne" dhe "ata". Stereotipat për të dy këta emra dëshmojnë se kemi pak e hiç historianë të duhur, aq sa edhe dëshirë për ta thënë të vërtetën. Sepse, Esat pasha nuk e meriton të jetë simbol i tradhtisë e as Avni Rustemi simbol i padiskutuar i patriotizmit.

Esat pashë Toptani ishte trim dhe e ka mbrojtur Shkodrën. Megjithatë, ishte edhe karrierist, dallkauk e i etshëm për pushtet. Pra, nuk është i shenjtë, por as

personifikim i djallit. Atë Zef Plumi te libri i parë "Rrno vetëm për me tregue" dhe te vepra "Siç thonim dje..." tregonte se, sipas arkivave të franqeskanëve që kishte parë si i ri, Esat pashë Toptani e donte një Shqipëri etnike. Po sipas tij, Avni Rustemi ishte patriot naiv që nxitet nga Luigj Gurakuqi e Mehmet Konica për ta vrarë Esatin. Këshilla e tyre ishte që të shkonte në Paris dhe të kërkonte bursë për studimet. Esati e takon dhe pranon se do ta ndihmojë meqë Shqipëria ka nevojë për njerëz të shkolluar. Kur Avni refuzon ta kryejë atentatin, ia mbushin mendjen për "tradhitë" e tij. Dhe, e vran njeriu që e mirëpritit.

Intelektuali dhe njeriu që e dokumentoi më së miri historinë shqiptare të dekadave të para të shkullit XX, Eqrem bij Vlora, në vëllimin e dytë të librit të tij, "Kujtime", ka shkruar: "Që Esat pasha në çdo vend të qytetëruar do ta kishte hak trekëmbëshin, kjo nuk diskutohet. Por, që ai u eliminua në këtë mënyrë të padenjë, kjo nuk i nderon aspak anëtarët e asaj qeverie (të Lushnjës - v.j.)". Ndërsa, për Avni Rustemin ka thënë: "Një djalosh i quajtur Avni Rustemi, një nga studentët më të pasuksesshëm, që me këtë vrasje donte të bënte emër, nuk ishte veçse një vegël

në duart e kundërshtarëve të Esat pashës. Ata i dhanë mjetet e nevojshme për këtë vrasje dhe morën njëherësh përsipër mbrojtjen e tij para gjykatës franceze... drejtësia franceze, me një manipulim të habitshëm të ligjit, e nxori të pafajshëm Avni Rustemin dhe që qeveria shqiptare e shpalli hero dhe e bëri deputet, kur ky vrasës i pabesë, pra kapardisej nëpër Tiranë si ndonjë shpëtimtar i atdheut".

Avni Rustemi ishte majtist. Ai ishte hero për Ahmet Zogun, pastaj për Fan Nolin e, mbi të gjitha, për regjimin komunist të Enver Hoxhës. Të gjithë këta e projektuan një armik që nuk e do të mirën e shqiptarit (Esatin) dhe një hero që kërcënons se kundërshtarëve, atyre që mendojnë ndryshe, u jepet dënim (Avniun). Ndjejkja e këtij modeli për të pushtuar dhe mbajtur "Kalanë", është i rrezikshëm sa nepotizmi, korupsioni e drejtësia e nëpërkëmbur. Sepse rasti i Enver Hoxhës dëshmon se krahasimi me të keqen çon te një e keqe tjetër, më e madhe.

Shqiptarët e shkullit XXI nuk kanë nevojë për Rozafën, Avni Rustemin e Esat pashën. As për viktima, tradhtarë e heronj të rinj. / Telegrafi



ÇDO DITË QË BËJMË 'JACK DANIEL'S', NE E BËJMË ATË SA MË MIRË QË MUNDEMI

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Është kjo motoja që përcjell mesazhin për uiskin më të mirë në botë, "Jack Daniel's", apo si uiski më i shitur, që vjen nga distileria më e vjetër e regjistruar në Amerikën e Veriut, "The Distillery", e themeluar në vitin 1866 nga Jack Daniel në Lynchburg, Tennessee. Është një nga prodhuesit më të njohur të uiskit në botë. Uiski Tennessee i "Jack Daniel's" përgatitet nga misri, thekëri dhe elbi. Karakteri i tij dallues

është një rezultat i fermentimit natyral, distilimit të kujdeshëm dhe përdorimit të ujit nga shpella e Pranverës që rrjedh me një konstante 56 °F. Kjo pije shitet në 170 shtete dhe është prej më të shiturave jashtë Amerikës, duke e përfshirë këtu edhe tregun e Kosovës, nëse llogaritet sipas banorëve, ndërsa Kosova është një nga tregjet më të suksesshme. "Kos-Trade" ka përfaqësinë e këtij produkti që 15 vjet në Republikën e

Kosovës, ku konsumatorët e të cilët vazhdojnë të shtohen. Drejtori i "Kos-Trade" dhe distributori ekskluziv i "Jack Daniel's", Blerim Sabedinaj ka thënë se kjo pije përvëç kualitetit dhe cilësisë, ka ndikuar edhe aktivitetet e marketingut dhe informimi i vazhdueshëm rreth brendit dhe historisë së saj. "Jemi në një pozitë të punës, ku ka nivele të larta besimi dhe komunikimi, mënyra se si ne punojmë ka të bëjë me bashkëpunimin, është

gjithçka një punë ekipore. Roli dhe prioriteti im është të motivoj stafin tim të punës, si dhe ndërtimi i marrëdhënieve të mira me blerës e konsumatorë", ka thënë Sabedinaj. Ai ka thënë në se të gjithë brenda kompanisë që punojmë me këtë brend, i bëjnë të ndjehen plotësisht të privilegjuar, pasi "Jack Daniel's" natyrë ikonike. "Ky produkt është gjithandje Kosovës, dhe tregu është i informuar se kush e sjell uiskin,

prioritet kryesor e kemi konsumatorin", ka thënë Sabedinaj. "Jack Daniel's" prodhohet në mënyrë dhe vend të veçantë,



andaj shija e tij, për ata që e konsumojnë rregullisht, e vërejnë që është e rrallë, pasi nuk është as "Scotch" dhe as "Bourbon", por është "Jack".

Ndërsa Filip Pletes menaxher kryesor i avokimit të brendit nga Brown Forman në këtë intervistë për "Epoka e re" ka treguar për eksperiencën e tij

me produkte të "Jack Daniel's" si banakier për kokteje, dhe si përgjegjës kryesor në Ballkanin Perëndimor për këtë fushë.

Filip Plantes cila është eksperiencia e juaj si banakier?
Unë kam punuar pas banakut për 12 vitet e fundit të jetës sime.

Fillova si një shankist kur isha

16 vjeç, karriera ime ishte mjaft emocionuese pasi kam ndryshuar shumë pozicione, dhe kam lëvizur nëpër kompani të ndryshme. Përvotajt e mia të preferuara janë padyshim duke punuar si menaxher i barit në Holland America Cruise Line, pasi kam qenë në gjendje të udhëtoj shumë dhe të mësoj nga secili vend që kam vizituar

Përveç asaj që të punosh si menaxher operacional në Nikki Beach International ishte gjithashtu një përvotajt unlike, pasi niveli i mikpritjes, së bashku me të ftuarit që vizitonin këtë bar janë mjaft të ndryshëm nga mysafirët e zakonshëm. Kemi përgatitur pije dhe kokteje shumë të mira, duke përdorur pijet më premium që janë në botë.

Na flisni për produktet e "Jack Daniel's"?

Unë i dua të gjitha brendet e "Jack Daniels Tennessee Whiskey", por i preferuari im është padyshim "Jack Daniel's Single Barrel", pasi besoj se kjo është shprehja e vërtetë të asaj se çfarë është një uiski amerikan, i fortë, i guximshëm dhe aromatik. E dua këtë shprehje, dhe më pëlqen të pi në dy mënyrat; sipas modës të vjetër dhe të pastër, siç edhe është. Unë e dua gjithashmërinë e produkteve tona dhe ne mund ta përdorim këtë në mënyra të ndryshme.

Me cilat produkte të "Jack Daniel's" preferoni më shume të punoni për kokteje dhe pse?

Siç u përmend më lartë, unë me të vërtetë i dua të gjitha produktet tona, pasi ato janë vërtet të gjithashme sidomos për mixologji apo përzierje, dhe ato mund të përdoren për pije komplekse, por edhe në pije të thjeshta me dy përbërës. Nëse i shikojmë sipas markës, më pëlqen t'i përzziej në mënyrën vijuese; "Jack Daniel's Old number 7", "Tennessee Mule Gentleman Jack - Gentleman Jack Sour Single Barrel - Old Fashioned" dhe "Jack Daniels Tennessee Mule - Honey Smash".

Llojet e koktejeve që njerëzit i preferojnë më shumë?

Njerëzit po zgjerojnë pikëpamjet mbi kulturën e koktejeve, dhe që kur po udhëtojnë ata janë në kontakt me kulturën e koktejeve më premium në Evropë. Zakonisht u pëlqen të ndryshojnë pijet e tyre sipas stinës, në kohën e

dimrit preferojnë kokteje më komplekse, më shumë alkool si bazë, ndërsa gjatë kohës së verës preferojnë pije të thjeshta, freskuese që nuk janë komplekse.

Si e shikoni kategorinë e njerëzve që fillimisht preferojnë një koktej më shumë sesa një pije tjetër?

Këta njerëz zakonisht janë ata që udhëtojnë shumë, dhe kanë përvotajt me pilet premium. Ata nuk kanë frikë të eksperimentojnë dhe provojnë gjëra të reja. Mbaj mend që 10 vjet më parë, koktejet ishin pije të zakonshme, të cilat bëheshin me pije me cilësi të ulët, me shumë përbërës dhe lëngje. Në ditët e sotme ne jemi duke bërë kokteje me pije premium, dhe ne po kërkojmë t'u japim të gjithë klientëve tanë një pamje dhe ndjenjë premium kur janë duke pirë pije që janë bërë me "Jack Daniels Tennessee Whiskey".

Na tregoni se si e shikoni tregun e Kosovës sa i përket komunitetit të banakierave, dhe posaçërisht për koktejet me produkte të "Jack Daniel's"?
Kam pasur një përvotajt të mahnitshme për herë të fundit kur kam vizituar Kosovën, dhe kam pasur një trajnim të "Jack Daniels Tennessee" të familjes se brendeve. Vullneti, entuziazmi dhe njojuria e banakierave të Kosovës është e mahnitshme, dhe besoj se ata do të bëjnë pije të mahnitshme në të ardhmen. Nëse ata vazhdojnë të punojnë shumë si tani, dhe të mësojnë me këtë ritëm, mund të presësh pije të mahnitshme të bëra në Kosovë shumë shpejt.

Cila është eksperiencia e juaj më e mirë gjatë punës tuaj me produktet e Jack Daniel's?

Udhëtimi dhe takimi i talenteve të reja ne fushën e banakierëve në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor është diçka për të cilën jam vërtet krenar dhe i lumtur. Të ndaj njojuritë dhe përvojën time me të gjithë klientët dhe banakierët në rajonin tonë është privilegji dhe nderi më i madh që kam marrë kohëve të fundit. Ndaja e dashurisë për Jack Daniels Tennessee Whiskey dhe për mitologjinë me portofolin tonë, është diçka që unë e dua më shumë, dhe mezi pres që të kthehem në Kosovë dhe të ndajmë sa më shumë dashuri! Filip Pletes përmes një video na ka treguar edhe si të bëjmë një koktej në kushte shtëpiake, ai e përmbylli intervistën me fjalinë: Konsumoni produkte të "Jack Daniel's", dhe konsumoni ato me përgjegjësi.



E jashtëzakonshme

Jetë përtej Tokës?

Studuesit besojnë se ekziston mundësia për të gjetur planetë të tjera të rinj si Toka. Ekspertët kanë zbuluar se disa galaktika kanë shumë yje të ngashme me Diellin. Studimet e kryera nga ekspertë britanikë kanë zbuluar disa grupe yjesht të cilët po monitorohen për të mësuar nëse formohen në të njëjtën mënyrë në të gjithë universin. Këto rezultate do të hedhin dritë për të kuptuar gjithashut si formohen planetët që janë të ngashëm me Tokën, por më të vegjël se ajo. Zbulimet vijnë pasi shkencëtarët e Institutit "Max Planck" vunë re një planet të ngashëm me Tokën, një yll që i ngjason Diellit tonë si në madhësi ashtu edhe në temperaturën e tij në sipërfaqe. Planeti KOI-456.04 është lokalizuar në të ashtuquaj-



turën "zonë e banueshme". Megjithatë, është e paqartë se si mund të jetë atmosfera e këtij planeti. Bazuar në studimin e tyre, shkencëtarët tani po përdorin simulimet kompjuterike për ta zbuluar origjinën e grupeve të rinj të yjeve që studian. Të dhënat e plota të këtij studimi janë botuar në revistën shkencore "Astrophysical".

FOTO E DITES



Demonstruesit shihen duke marrë pjesë në një protestë në Llos Anxhelos. /AP/

E rrallë

'Oqean' në mes të Seulit

Në kohë pandemie, kur udhëtimi duket i pamundur, në kryeqytetin e Koresë së Jugut ofrojnë këtë zgjidhje: një oqean në mes të qytetit. Janë kaq reale në imazh dhe tingull saqë efekti është i jashtëzakonshëm jo vetëm te qytetarët e Seulit që ndalojnë të shijojnë nga afër valët e mrekullueshme, por edhe për ne që e ndjekim nga ekrani. I quajtur "Public Media Art-Wave", projekti është realizuar nga një kompani vendëse me teknologjinë 3D. Drejtues të saj thonë se kohët e fundit kanë marrë shumë kërkesa nga jashtë, përfshirë një kompani në Nju Jork që punon me



tabelat publicitare në "Times Square". Projekti që ka për qëllim promovimin e natyrës do të shfaqet deri më 31 qershor. Ndërkohë Qeveria e Koresë së Jugut po lehtëson disa kufizime për të shkuar drejt riapries së shkollave dhe bizneseve.

Në ora 18:00
Jumanji; The Next Level 3D


Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan

Në ora 18:00
STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
Regjia: J.J. Abrams

Çdo natë në ora 20:00
THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min



Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea DuVall and Bill Pullman
Regjia: Takashi Shimizu

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Do të duket se është e pamundur

për të gjetur një pikë takimi me njerëzit përeth jush. Më mirë t'i zhvendosni vendimet dhe nismat për një ditë tjeter.



DEMI
Ju nuk mund ta përfundonit më mirë se

kaq javën. Klima pozitive vazhdon në jetën tuaj, interesa të reja dhe njerëz të rinj hyjnë në jetën tuaj.



BINJAKËT
Do të krijohet mundësia për të

zgjidhur shpejt një problem që ju bezdis. Do të kenë dikë pranë jush që do t'ju japë stimujt dhe sugjerimet që ju nevojiten tani.



GAFORRJA
Do të rregullohet qëndrueshëmëria në martesën

tuaj. Deri më tanë keni qenë të penalizuar nga mungesa e dialogut, paqartësitet dhe nga dyshimet që keni pasur për të dashurin tuaj.



LUANI
Ju keni një humor pozitiv, të paktën për sa kohë që

nuk përballeni me kundërshtime. Përkushtojuni vetes dhe bëni atë që ju pëlqen, por mos harroni gjérat e rëndësishme.



VIRGJËRESHA
Do të keni ndikime të shkëlqyera nga jyet për projektet që keni. Momentet e argëtitimt do t'ju bëjnë ditën më të bukur. Ju keni aftësinë të lini pas problemet dhe të merrni jetën ashtu siç vjen.



PESHORJA
Mos jini të padurueshëm, ju po ndërtoni ndërtesën e

suksesit tuaj e kjo varet nga themelat! Do të përballeni me disa ngjarje të paparashikuara, nese keni dyshime.

AKREPI



Kënaqësitet dhe sukseset do t'i tejkalojnë pritet tuaja.

Miqësi të reja do të lindin në këtë ditë, por edhe projekte të reja që do të realizohen në ditët në vazhdim. Kjo do t'ju ndryshoje për mirë.



SHIGJETARI
Është më mirë të hiqni dorë nga negocia-

atat e biznesit ose lëvizjet e fortë të parave: ju rezikon të bën gabime, të komprometoni një fitim të marre tashmë si të mirëqenë.



BRICJAPI
Do të jeni më pak të dyshimtë, më pajtues

dhe tolerant sesa jini zakonisht. Do të keni, gjithashut, një sens të këndshëm humorë dhe do t'jeni në gjendje të qeshni edhe me veten tuaj.



UJORI
Një lajm mund t'ju bëjë të mbyllen në

shtëpinë tuaj dhe të dëshironi situata që përcjell i vetëm qetësi. Dikush (partneri, një mik) mund t'ndihet i lënë jashtë.



PESHQIT
Energjitet pozitive ju ëmbësojnë karakterin

dhe gjendjen shpirtërore.

Zgjidh më mirë të kalosh mbrëmjen me miqtë tuaj të jetë. "Old Friends" është gjithmonë opsjon i mirë.

BARSOLETA E DITËS



Gjakovari dhe e dashura

- Sa aromë e mirë që vjen këtu!
- Vjen nga ëmbëltorja. Të pëlqen?
- Po, shumë.
- Nesër përsëri të kalojmë këtupari.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00
Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno

Në ora 18:00
Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan

Çdo natë në ora 20:00
STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
Regjia: J.J. Abrams

Çdo natë në ora 22:30
THE GRUDGE


Horror/Mister; 1 orë 34 min



Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea DuVall and Bill Pullman
Regjia: Takashi Shimizu



Afrona Dika ‘mahnit’ me pamjen natyrale



Modeluesja Afrona Dika, bashkëshortja e këngëtarit Blero, ka “mahnitur” edhe një herë me një foto të postuar në llogarinë e vet në “Instagram”. Ajo shpeshherë publikon foto ku shihet e rregulluar deri në detaje, mirëpo nuk i kurset as fotot në të cilat shfaqet e pagrimuar dhe tërësisht natyrale. Njësoj ka vepruar edhe me postimin e fundit, foto e realizuar teksa ajo po dilte për vrap. Kujtojmë se shkak i pandemisë kishte kaluar kohë e gjatë nga takimi i fundit me burrin e saj Bleron.

Lei Kraja nis plazhin në Durrës, merr vëmendjen me pozat në bikini



Lei Kraja u është rikthyer pozave në bikini. Për shkak të gjithë ishin bllokuar brenda shtëpive të tyre dhe nuk kishin mundësi të dilnin për t'u argëtuar. Njësoj ka ndodhur edhe me prezantuesen e sportit, Lei Kraja, e

cila më në fund është e lirë që t'i shijojë ditët e nxehta në plazh. Këtë e ka bërë të ditur vetë nëpërmjet publikimit të dy fotografive në llogarinë e saj në “Instagram”, aty ku reklamon bikinitë, format trupore e në të njëjtën kohë merr rreze dielli.



Beatrix Ramosaj, e zhytur në shkumë, publikon foto nga vaska

Beatrix Ramosaj vazhdon të qëndrojë aktive në rrjetet sociale duke publikuar fotografi rregullisht, bukurossja ka provokuar me postimin e fundit. Ajo ka hyrë në profilin e vet në “Instagram” për të shpërndarë një fotografi nga vaska, ku shihet e

mbluar me shkumë. Këngëtarja dhe modeluesja është kthyer në Prishtinë pas një kohe të gjatë, bën të ditur në pëershkrimin e fotos “Natën e mirë Prishtina, ndihem shumë mirë pas rikthimit”, ka shkruar ajo në llogarinë e vet në “Instagram”.

‘Hot’ me bikini, vajza e ish-deputetes lë pa fjalë ndjekësit me pozat seksi



Prej kohësh ajo është kthyer në një nga modelet shqiptare më të komentuara në mediat online. Është fjalë për Ada Dedën, e cila në profilin e vet në “Instagram” ndan me ndjekësit foto shumë sekci. E kështu ka bërë edhe së

fundmi. Vajza e ish-deputetes, Albina Deda, ka publikuar një foto ku shfaqet me bikini. Pozat e saj kanë marrë me mijëra pëlqime si dhe qindra komente, ku ndjekësit nuk ia kanë kursyer komplimentet bukurosshes.



Olga Tokarczuk: Gishti që tregon hënën

Në fillim të vitit 2009 (pasi botova Fjalarin Polonisht-Shqip në Tiranë, i cili ishte fjalori i parë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Poloni, me 25 mijë zëra dhe me shumë shembuj, shprehje frazeologjike e fjalë të urta) nga Instituti i Librit i Polonisë më erdhi një ftesë për të marrë pjesë në Kongresin Botëror të Përkthyesve të Letërsisë Polake që u mbajt nga 3 deri 7 qershor 2009 në Krakow nën kujdesin e Ministrisë të Kulturës dhe të Trashëgimisë Kombëtare të Polonisë.

Në këtë Kongres merrnin pjesë mbi 250 përkthyes të letërsisë polake nga të gjitha kontinentet. Shtetet dhe gjuhët europiane përfaqësoseshin me disa pjesëmarrës. Nga vendi ynë ishin ftuar përkthyesi i mirënjohur i polonishtes Astrit Beqiraj dhe unë. Veç përkthyesve të huaj, në Kongres binin në sy dhe personalitetet të letërsisë polake: shkrimitarë dhe gjuhëtarë që lexonin në seksione të ndryshme ligjérata. Dalloheshin mes tyre poetja nobeliste Vislava Shimborska (W. Szymborska), poeti më në zë në atë kohë në Poloni e më gjërë Adam Zagajewski (A. Zagajewski), prozatorja e re e talentuar Olga Tokarczuk (O. Tokarczuk; lindur më 1962 në

Sulechów, Silezi e Poshtme, Poloni) etj. Ligjérata e O. Tokarczukut më tërroqi shumë se lidhej me gjuhën dhe në pushim iu luta ta fotokopjoja. Ajo me një buzëqeshje më pyeti me dashamirësi: "I pëlqeu zotërisë?" Ia pohova me kënaqësi. Ajo më dha tekstin original të ligjératës që ende e mbante në dorë dhe më tha: "Urdhëro, mos ma kthe... kam kopje tjetër."

Vitet kalonin dhe Olga Tokarczuk bëhej gjithnjë dhe më e famshme jo vetëm në Poloni, por dhe në botë, derisa më 2018 fitoi çmimin Nobel në letërsi duke u bërë nobelistja e pestë e Polonisë në letërsi (pas: H. Sienkiewicz më 1905, W. Reymont më 1924, C. Millosh më 1980 dhe V. Shimborska më 1996) dhe e shtata në plejadën e nobelistëve polakë (M. Skłodowska-Curie dy herë: më 1905 në fizikë dhe 1911 në kimi si dhe L. Vallensa çmimin përpaga më 1983).

Ligjératën originale, me shënimë me laps të shtuara nga vetë Olga Tokarczuk, atëherë shkrimitare e re, jo fort e njohur, e ruajta si kujtim të çmuar dhe relikt letrar se e çmova si një prozë e shkruar nga një talent që ishte ende në hapat e para të shkëlqimit në letërsinë botërore. Sot që ajo mban

laurën e çmimit Nobel, po ia bëjtë njohur lexuesit tonë.

Kuptimi i vetëdijsëm nga njeriu i gjuhës së vet, me të gjitha dhunitë e saj, me dobitë e përfitimet, si dhe me kufizimet e trillet, të krijon përshtypjen e një psikanalize të tejzgjatur. Ajo nxjerr në pah gjithë bagazhin që mbartim jo për arsyen të gabimeve e fajeve, apo meritave tona, por për arsyen që u lindëm në një vend, në një kohë apo në një formë. Pra, në njëfarë kuptimi gjuha është një fat i pash-mangshëm letrar. Ajo gjithashtu tregon si pëllëmba e dorës se në gjuhë vetëm deri në njëfarë shkalle mund të jemi vetvetja (dhe "të jesh vetvetja" do të thotë të jesh vërtet një postulat i kulturës sonë), ndërsa në një shkallë të madhe i nënshtrohemë asaj, e cila është më e rëndësishme, më e fuqishme se ne dhe mbi të cilën nuk kemi ndikim.

Nuk ka asgjë të çuditshme që filozofët së fundi lanë pas dore Hyjinë, Qenien, Pse më Mirë Dicëka se sa Asgjë dhe u morën me gjuhën.

Shkrimitarët shpesh bëjnë gabim duke e trajtuar gjuhën si domenin e tyre të liri, kur në oqeanin e madh të zanafillës, aminoacidet e para formulojnë mendimet tona individuale dhe mënyrat e shprehjes. Pra, duket

se akset e kristalizimit u vendosën dhe ne nuk kemi ndikim mbi to. Kuptohet që në gjuhë jemi të hedhur.

Unë u hodha në polonisht. Linda dhe u rrita në tokat perëndimore të Polonisë që u bashkuan me pjesën tjetër të vendit pas luftës dhe u banuan me përzierjen e madhe të pasluftës të kulturave dhe dialekteve polake. Në këtë furre shkrirje, siç theksojnë gjuhëtarët, u krijua modeli i polonishtes dhe ka të ngjarë që ne në Silezinë e Poshtme flasim polonishten standarde. Nuk flas me shprehje e huazime të ndonjëdialekti dhe me asnje theks.

Nuk di aq mirë asnje gjuhë tjetër, saqë të mund ta trajtoj atë si gjuhë të letërsisë që shkruaj. Jam, pra, njëgjuhëshe. Nuk do të mund të shkruaja në një gjuhë tjetër. Mund të komunikoj në dy gjuhë të tjera, por vetëm në një bisedë të thjeshtë dhe në njëfarë kuptimi kjo është e dhimbshme. Mund të vendosem në Sevres pranë Parisit, atje ku mbahen të gjitha shablonet, si shembull i personit polonishtfolës në mënyrë të përsosur. Qëndroj në polonishtë si miza në qelibar. Polonishtja bën pjesë në grupin e madh të gjuhëve sllave; rrjedhimisht, në familjen indoeuropeiane. Në shkrim filloi të formohet mjaft vonë, përndryshe

në shekullin XII. Marrja e krishterimit nga Roma dhe jo nga Bizanti pati një rëndësi të madhe – i lejoi polonishtes të hyjë në sferën e kulturës latine dhe të marrë alfabetin latin (siç dihet, disa gjuhë sllave morën përbazë për alfabetin e tyre atë grek – për shembull rusishtja apo bullgarishtja). Vetëm më 1270 në Librin e Henrikovës, të hartuar, në fund të fundit, në Silezinë e Poshtme, u shkrua fraza e parë polonisht dhe kjo në një kontekst mjaft interesant. Teksti latin tregonte me pak fjalë për një farë Boguchwale i cili – përbashkëkohësit dukej si diçka e pazakontë, aq sa t'ia viente të shkruhej – ndihmonte gruan në bluarjen e drithit. Pikërisht ai tha frazën e parë të famshme: "Day ut ia pobrusa a ti po ywai", që në polonishten e sotme do të thotë: "Më lejo ta bëj unë këtë dhe ti pusho."

Shtrirja gjeografike e Polonisë, ndërmjet dy fqinjëve të fuqishëm në mes të Europës, në afersi të kulturave të ndryshme, ka ndikuar që në polonishtë të depërtojnë shumë fjalë të huaja. Leksiku i polonishtes përmban deri 70 për qind fjalë të huazuara nga gjuhët e tjera, gjë që është e rrallë në sfondin e gjuhëve të tjera. Pra, është një gjuhë e përbërë, gjuhë e kompozuar me arnishtë, furre

shkrirjeje dhe përzierjeje. Kemi marrë fjalë nga fqinjët – për shkak të veprimtarisë tregtare që kemi bërë me ta, të luftërave, të udhëtimeve, të modës dhe magjepsjes pas së bukurës. Gjermanëve u jemi mirënjojës për terminologjinë e pasur teknike. Çdo risi depërtoi te ne përmes fqinjëve perëndimorë, me të cilët kemi pasur gjithash tu shumë probleme – ngulimet gjermanike në tokat polake kanë qenë gjithmonë njëgrup i fuqishëm ekonomik, i organizuar mirë. T ngritën një rebe llim në Krakov, duke i urdhëruar të shqiptonin fjalët që vijojnë: *soczewica, koto i miele myn* (thjerrëza, rrota dhe mulliri bluan). Ata që nuk dinin t'i shqiptonin në mënyrë të përpiktë – ndëshkoheshin. Së bashku me mbretëreshën Bona mbërritin në Poloni shumë fjalë italisht, kryesisht nga fusha e arkitekturës, e muzikës, e artit ushtarak dhe para së gjithash, nga kulinaria. Në shekullin XVII ndodhi zbarkimi i frëngishtes. Ndikim të madh ka pasur edhe gjuha ruse dhe gjuhët e tjera të Lindjes. Madje, mund të krenohemi me hyrje të turqizmave dhe fjalëve të hungarishtes. Latinishtja shtoi polonishten me fjalë e shprehje nga fusha e shkencës, e koncepteve abstrakte dhe fetare. Në shekujt XV dhe XVI ishte e modës çekishtja dhe kishte opinion të mirë ai që tre gonte në një shoqëri të lartë njo hje të çekishtes. Gjatë shumë viteve të pushtimit u bë në mënyrë aktive dhe shumë intensive gjermanizimi dhe rusifikimi. Sot – si gjithkund në botë – ka kaluar në mësymje anglishtja.

Mua më pëlqen hapja e polonishtes kundrejt fjalëve të huaja – dhe të mos shqetësohem, asaj nuk i kanoset asnjë rrezik; në shtjellën e papërbajtut që ajo krijon edhe fjalët e huaja me shqiptim të largët për të, përfshihen në mullirin e fuqishëm të gramatikës së polonishtes, sepse ngjiten tek ato mbaresat e saj të veçanta dhe kalandrohen nga lakimi përmes rasave.

Megjithatë, kjo gjuhë e kompozuar me arnishtë ka përbushur rolin e Jashtëzakonshëm e paradoskal – në periudhën shumëvjeçare të okupimit nga pushtuesit u bë shtyllë e identitetit kombëtar, kurse letërsia, që u krijua në këtë kohë, ishte i vetmi vend i mbijetesës të kulturës polake. Për gjuhën polonisht u luftua, për të folur polonisht u flijua edhe jeta. Sot eshtë vështirë ta përfytyrosh këtë.

Për shkrimtarin funksionin ndihmës të psikanalistëve e kryejnë shpesh përkthyesit – ata bëjnë pyetje nga më të habit shmet. Do të duhej të mba heshin shënim, të ruheshin dhe të btoheshin në tirazh të veçantë, që lexuesit të kishin mundësi të çmonin mrekullinë e të shkruarit dhe sfilitjen e përkthyesve. Falë tyre, ajo që më dukej e natyrshme dhe e


përgjithshme papritmas humb kohezionin e saj të brendshëm dhe bëhet joreale dhe krejtësisht lokale. Janë pikërisht ata që më drejtuani vëmendjen në disa karakteristika të polonishtes, të cilat po i tregoj më poshtë. Të gjithë të njohurit e huaj, këta njerëz të guximshëm, të cilët vendosën të mësojnë polonishten, kanë të njëjtën gjë. Ata anko hën shpesh se gramatika e polonishtes përbëhet kryesisht nga përjashtime, se duhet të mësojnë rregulla të vështira, të cilat në çast bëhen të pavlera nga sasia e madhe e përjashtimeve të mundshme. Kjo eshtë e vërtetë – në polonishtes ndosh ta më mirë eshtë të hysh me intuitë sesa të mësosh përmendsh. Polonishtja eshtë një gjuhë, e cila vëmendjen ia kushton traditës dhe trajtave historike, eshtë gjuhë-muze – plot me fosile, të cilat nuk eshtë e mundur t'u nënshtronë parimeve të pragmatizmit. Lakimi dhe zgjedhimi i ndërlíkuar jo vetëm që shton dhe heq mbaresa, por ndryshon edhe rrënjen e fjalës. Kemi kohën e ardhshme të aspektit të kryer dhe të pakryer të foljes, e cila demaskon madje dhe gjermanin që flet më mirë polonisht. Në drejtshkrim ekzistojnë disa tinguj të njëjtë, që shkruhen në mënyra të ndryshme sepse në të shkuarën i shqiptonin ndryshtë dhe mbetën në gjuhë si kujtim që mbjellin panik te gjimnazistët. Gjuha polonishtë nuk eshtë as gjuhë logjike as pragmatike. Gramatika e saj eshtë kërkuese, madje e marrosur, drejtshkrimi i vështirë. Me gjithë plasticitetin leksikor, mban për arsyen logjike (mundet pra sentimionale) trajta të vjetra tradicionale gramatikore dhe drejtshkrimore. Eshtë gjithashtu gjuhë tradicionale edhe për një arsyen tjetër – eshtë mashkullorecentriste. Ndërmjet tri gjinive që disponon i jep pozicion të privilegjuar gjinisë mashkullore. Emrat e gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjane ndryshtë lakohen në vetë, rasë, ndërsa foljet zgjedhohen ndryshtë në kohë për gjininë mashkullore dhe femërore. Ndër to sundojnë edhe mjaft përjashtime. Për meshkujt themi se: *poszli* (poshli = shkuhan). Për femrat themi se: *poszły* (poshli = shkuhan), ndërsa për një grup të përzier me femra dhe meshkuj – gjithmonë duhet thënë “në mashkullore” – *poszli*. Ky parim vepron edhe atëherë kur në një grup po themi prej gjashtëdhjetë femash ndodhet një mashkull, prania e tij na detyron të përdorim trajtën mashkullore për gjithë grupin – *poszli*. Femrat, fémijet dhe kaf shët do të përfaqësohen në këtë rast nga forma femërore. (*Me shkrim dore e laps* eshtë shtuar: si tualetet në aeroporte... *Fraza vazhdon*, por eshtë krejtësisht e palexueshne A. T.). Për meshkujt eshtë e rezervuar kjo e privilegjuara – mashkullore.

Natyrisht, vetë fjala njeri – njëloj si dhe në gjuhët e tjera – eshtë e gjinisë mashkullore. Duke folur, pra, në mënyrë të përgjithshme për njeriun do të përjashtojnë gramatikisht nga ajo fjalë femrat (dhe fëmijët). Ky patriarkalizëm pasqyrohet gjithashtu dhe në emrat e profesioneve. Gjuhët e tjera ia kanë dalë mbanë (si për shembull gjermanishtja), ndërsa në polonishtë vazhdimisht me këtë




ka telashe e siklete. Emrat femërorë të profesioneve thuhen në polonishtë trajtë zvogëluese të mashkullorës, gjë që shkakton përshtypje joserioze dhe fsheh me siguri një kup tim përcmues të thellë – femra profesor – profesorka (*profesoreshë A.T.*) – tingëllon si profesor mashkull i vogël (*profesorek*).

Nga natyra mashkullorecentiste e polonishtes shumë herë jam ndeshur me thënien *pisarka* (*shkrimtarja A. T.*) (që eshtë



trajta femërore e “pisarz” (*shkrimtar A.T.*). Në polonisht, siç dihet, nuk mund të lihet mënjanë gjinia e atij që shkruan, kur përdoret veta e parë. Gjinia eshtë menjëherë e dukshme në foljet e kohës së shkuar, kurse në të tashmen e mënjanon atë trajta femërore e mbiemrave. Nga kjo nuk mund të ikim. Ka pasur telashe përkthyesja e librit të Jeanette Winterson, ku në mënyrë konsekutive përdoret veta e parë e kohës së tashme, që ia ka dalë të fshehë gjininë e tregimtarit/res, çka ishte thelbi i këtij romani. Ishte e pamundur të shkëputet “nga gjinia” dhe arbitrarisht i duhej t'i përshtatej gjinisë së asaj/ atij – në këtë rast femërores. Meqë erdhë fjalë, ju kujtoj se polonisht “mother tongue” eshtë “father tongue”, “jzyk ojczysty” (gjuhë atëreore


A.T.). Polonishtja, sikurse edhe gjuhët e tjera sllave, përbanë në vetvete një potencial të madh në sferën e fjalëformimit, veçanërisht arrin të krijojë në përmasa të mëdha shumë trajta zvogëluese, gjë që sjell një shkrepimë gjuhësore. Për mua kjo eshtë një dukuri e ngrohtësisë gjuhësore, kategori që eshtë lënë pas dore në tekstet e gramatikës. Kjo eshtë veti e gjuhës që në mënyrë të papërsëritshme dhe magjike e bën botën të rehatshme dhe të sigurt. Askënd në Poloni nuk e çuditin fjalët e këngës popullorë për ushtarin që shkon në “wojenk” me “szabelk” në brez, sipër mbi “koniku” (“wojenk” trajta përkëdhelëse ose zvogëluese e fjalës wojna=luftë; “szabelk” zvogëlim i fjalës szabla=shpatë; “koniku” zvogëlim i fjalës ko=kalë A.T.). Mënyrat e përdorimit të trajtave zvogëluese apo përkëdhelësejanë të shumta dhe që do emër njeriu mund t'i nënshtron



het këtij trajtimi. Po kështu mund të bëhet dhe me çdo emër dhe mbiemrë gramatikor. Deri në Luftën e Dytë Botërore Polonia ishte vend shumëkulturnësh dhe shumëgjuhësh dhe për këtëjemi krenarë. Atje ku polonishtja u takua me gjuhë, ndjeshmëri e mendësi të tjera – atje ajo ishte më krijuese. Nuk eshtë fare rastësi që mjeshtrit e gjuhës polonisht kanë dalë nga periferia e Poloni. Kështu eshtë proza mahnitëse dhe e papërsëritshme e Bruno Schulzit që u krijua në kontaktin polako-hebraik-ukrainas. Po kështu poezia figurative dhe e pasur e Czesław Miłosz-it, i cili e kishte prejardhjen nga Vilna, apo absolutisht përrallore, por fatkeqësisht e vështirë në përkthim, polonishtja e Bolesław Le mian-it dhe Julian Tuwim-it nga kufiri hebraik-polak.

E epshme, e figurshme, e mjegullt, jo fort e përpiktë, tradicionale dhe gramatikisht e pallogaritshme... Më tepër e krijuar nga intuita sesa nga arsyaja, më tepër për poezi sesa për disertacion shkencor. Kam përshtypjen se nuk ndihet mirë në një diskutim intelektual as në tregimin realist linear të ngjarjeve. Dëshiron botën se sa e përshkruan, gjuhë-impresjonisti, e aftë të shprehë përshtypje, gjendje shpirtërore, parandjenja, e hapur në lidhje e shoqërimë duke ndërtuar tablo. Më duket se Flaubert (*Flober*

ngulte këmbë se gjuha pëson dështim kur fillon të krijojë tablo; pasi atëherë largohet nga vetvetja dhe rrëshqet në anakronizëm. Nuk jam dakord me këtë konstatim. Gjuha eshtë më e fuqishme atje ku del jashtë vetvetes dhe bëhet krijuese e botës alternative, kur, sikurse iluzionisti nxjerr nga kapela sende të cilat nuk do të kishim ditur madje as t'i imaginonim. Polonishtja për mua eshtë gjuhë arkaikë, e cila i përgjigjet botës para diferençimit të saj, kur gjithçka ka të ngjarë të ishte më kompakte, më e perceptuëshme nga shqipat, kur ekuilibrohej në intuita dhe “çfarë” ishte më e rëndësishme se “si”. Gjuhën e trajtoj si – le të marrim këtë krasim oriental – gishti, që tregon hënën. Nuk përbahem për gjuhën. Ndjeshmëria ime deri në njëfarë mase kureshtare, perceptimi im dhe të menduarit u trajtësuan nëpërmjet polonishtes së vështirë, pak precise, por shumë figurative. A do të mund të shprehja ato që aq shumë më preukupojnë në të shkruar – intuitën, gjendjen shpirtërore, shqetësimin, i cili më zë priti duke nxjerrë si arsyé konstante sigurinë e formimit të ndodhive në një gjuhë tjetër. Mbështetje t'i jem mirënjohezë këtij fati të pashmangshëm gjuhësor? Polonishtja hyn paradoksalisht në gjuhët e ashtuquajtura të vogla, megjithëse atë e flasin në botë mbi 50 milionë njerëz (duke numëruar edhe emigracionin e madh polak). Ajo eshtë gjuhë lokale, periferike e aq më tepër e vështirë dhe largon nga vetja shumë njerëz. Veti e këtyre gjuhëve të “vogla” – veçanërisht kur njeh dhe ato të “mëdhatë” – eshtë mundësia e strehimit, arratisjes në gjuhë dhe vendosja në një vend pak të shkelur dhe të paarritshëm për pjesën tjetër të botës. E njoh nga e kaluara këtë përvjetorë të fshehjes në polonishtë në aeroportet e mëdha botërore, larg kufijve të vendit, kur mund të ishim të sigurt se askush nuk na kuptonte ne që flisnim polonisht. Sot eshtë ndryshtë. Emigracioni i madh polak në vitet e fundit e ka lejuar polonishten të shtrihet së bashku me të gjerësisht në botë, por nuk mendoj se do të mund të ndikojë kjo në shtrirjen e përgjithshme ndër të huajt. Ka të ngjarë që do të duhet të mësojmë me zell anglishten dhe kjo do të jetë mënyra për të komunikuar me botën. Shenjë e kapercimit të kufirit do të jetë bar-kafeja më e afërt dhe pyetja e kamerierit “kaweczka” (trajta përkëdhelëse e fjalës kawa=kafe A.T.) të jetë me “mleczkiem” (trajta përkëdhelëse e fjalës mleko=qumësht A.T.). Gjithashtu mund të dëgjojmë përhëndetjen e faktorës polak, që thérret gëzueshmë “Bileciki do kontrolli!” (Bileciki trajta zvogëluese e fjalës biletat; kontrolli i biletave A.T.). (Kjo ligjératë u mbajt në Universitetin e Baptisteve në Hong-Kong). Prof. Arqile Teta/exlibris.al



Drenica e zbret Ballkanin nga froni



Dy rezultate befasuese janë regjistruar të dielën në Superligë. Dy skuadrat synuese për titull, Ballkani dhe Gjilani, janë ndalur në barazim nga Drenica, përkatësisht Trepça '89. Kryesimin pas kësaj xhiroje e ka marrë Drita e Gjilanit, e cila e ka mposhtur të shtunën Flamurtarin

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Skuadra e Ballkanit ka gabuar në ndeshjen ndaj Drenicës pasi nuk ka arritur të marrë më shumë se një pikë (0-0). Ky barazim i ka kushtuar skuadrës së drejtuar nga trajneri Ismet Munishi, pasi ka rënë në pozitën e dytë në elitë. Loja ishte mjaft dinamike dhe vendësit tentuan të shënojnë të parët nëpërmjet Kushtrim Gashit, por gjuajtjen e tij e ndali portieri i kuqezinjve, Arion Ymeri. Në minutën e 14-t Alban Shillova dështoi përballë portierit Ruxhi. Më pas sulmuesi i talentuar Jetmir Topalli depërtoi për mrekulli dhe e shërbue Maganin, i cili nuk arriti të shënojë. Pjesa e parë u mbyllë me këtë rezultat, kurse tre minuta pasi filloj pjesa e dytë Kuçi tentoi nga largësia, por nuk arriti të shënojë. Mysafirët arritën të shënojnë, por goli u anulua për shkak të pozitës jashtë loje. Dhjetë minuta para fundit, Kuçi pati rast të mirë shënim, por topi u ndal nga shtylla. Pas kësaj xhiroje Ballkani bie në pozitën e dytë me 45 pikë, një pikë më pak

se Drita e Gjilanit.

Ndërsa Drenica është në pozitën e shtatë me 31 pikë. Edhe ndeshja tjetër që u zhvillua në Gjilan në mes të Gjilanit dhe Trepçës '89 përfundoi me rezultat të barabartë 1-1. Në minutën e 40-të Fiton Hajdari e kaloi në epërsi skuadrën vendëse. Tetë minuta pasi filloj pjesa e dytë Arb Manaj e barazoi rezultatin 1-1 dhe me këtë rezultat përfundoi ndeshja. Gjilani është në pozitën e tretë me 42 pikë, derisa Trepça '89 renditet në pozitën e nëntë me 27 pikë. Ndërsa të shtunën fitore kanë regjistruar Drita dhe Feronikeli ndaj Flamurtarit dhe Vushtrrisë. Skuadra gjilanase, Drita, që është lidere e re në Superligë, e imposhti Flamurtarin me rezultat minimal 1-0, derisa golashënuar ishte Astrit Fazliu që shënoi me gjuajtje me kokë pas harkimit të shkëlqyeshëm të Xhevdet Shabanit. Në ndeshjen tjetër, kampioni në fuqi i Kosovës, Feronikeli, arriti fitore të lehtë ndaj Vushtrrisë (3-1). Golat për skuadrën nga Drenica i shënuan Harmon Gbowea, Mevlan Zeka dhe Lapidar Lladrovci, ndërsa për mysafirët golin e vetëm e shënoi Valmir Azemi.

IPKO SUPERLIGA

Ballkani - Drenica	0-0
Gjilani - Trepça '89	1-1
Feronikeli - Vushtrria	3-1
Drita - Flamurtari	1-0
Llapi - Dukagjini	4-1

TABELA

1. Drita	23	46 pikë
2. Ballkani	23	45
3. Gjilan	23	42
4. Prishtina	22	41
5. Feronikeli	23	37
6. Llapi	23	37
7. Drenica	23	31
8. Flamurtari	23	28
9. Trepça '89	23	27
10. Ferizaj	22	25
11. Vushtrria	23	16
12. Dukagjini	23	10

Në xhiron e radhës takohen: Llapi - Drenica, Dukagjini - Feronikeli, Vushtrria - Prishtina, Ferizaj - Gjilani, Trepça '89 - Drita, Flamurtari - Ballkani.

SHKURT

Emini mposhti koronavirusin

Futbollisti Izair Emini u është rikthyer stërvitjeve me skuadrën e Dritës nga Gjilani. Anësori i klubit gjilanas kishte dalë pozitiv me Covid-19, por me ritestimet e reja të bëra në shtetin e Maqedonisë Veriore, Emini në dy raste pasuese ka dalë negativ. Futbollisti tetovar në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se tashmë e ka mposhtur koronavirusin. "Izair Emini vs Covid-19, 3:0 (1). Shumë i lumtur për rikthimin në fushë përsëri", ka shkruar Emini.

Islami operohet me sukses: Tash fillon faza më e vështirë

Mbrojtësi i Feronikelit, Përparim Islami, është operuar me sukses. Lajmin e ka konfirmuar Islami nëpërmjet një postimin në profilin e vet në "Facebook", "Sapo mbarova operacionin dhe çdo gjë ka shkuar mirë. Faleminderit Zotit! Tani fillon pjesa më e vështirë e rikuperimit ku duhet shumë punë. Sigurisht mua nuk më mungon puna, vullneti për të punuar sepse çdo gjë që kam arritur deri sot e kam arritur me punë, djersë dhe sakrificë. Faleminderit të gjithëve për mbështetjen dhe interesimin që keni treguar përmua", ka shkruar Islami. Ndërsa skuadra e Feronikelit fitoren e arritur në ndeshjen ndaj Vushtrrisë (3-1) ia ka dedikuar pikërisht Islamit.

Finalja e Ligës së Kampionëve zhvendoset nga Stambolli në Lisbonë

UEFA po planifikon që finalen e Ligës së Kampionëve ta zhvendosë nga Stambolli në Lisbonë për shkak të situatës së koronavirusit. Ky vendim është marrë nga UEFA, kurse do të bëhet zyrtar në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv më 17 qershor. Katër ndeshjet e pazhivilluara të fazës së 1/8-ave planifikohet të zhvillohen në muajin Gusht, kurse të gjitha ndeshjet nga çerekfinalat parashikohet të zhvillohen në Lisbonë.

Koeman: Është një të gjithë trajner i Barçës

AMSTERDAM, 7 QERSHOR - Ronald Koeman e pranoi në programin "Tot Gira" në "Radio Catalunya" se ai ende shpreson të drejtojë në të ardhmen Barcelonën. "Të gjithë e dinë që është një të gjithë trajner i Barçës".

Barçën një ditë", ka thënë Koeman, i cili në fillim të vitit kishte një mundësi, por e kuptoi se nuk kishte ardhur koha, pasi po drejtonte Holandën. "Shpresoj të kemi një shans tjetër në të ardhmen dhe jam akoma i

sigurt që do të varet nga karriera ime sepse duhet të kesh shumë përvojë për të stërvitur një ekip si Barça. Pata një telefonatë, por e kam shpjeguar disa herë, duhej ta mbaja fjalën time me ekipin kombëtar. Në atë kohë po

mendoja për Evropianin që do të zhvillohej në verë, po koronavirusi ndryshoi gjithçka. Sot gjëja më e rëndësishme është kombëtarja, atë që do të ndodhë në të ardhmen askush nuk e di", ka deklaruar trajneri holandez.



Boksierët e Kosovës përgatiten në Brezovicë

Prishtinë, 7 qershor (ER) - Boksierët e Përfaqësueses së Kosovës kanë filluar përgatitjet në Brezovicë. FBOXK-ja ka paraparë fillimin e përgatitjeve (bazike malore) me boksierët cilësorë në të dyja kategoritë të ndarë në tri grupe. Boksierët seniorë në kategorinë A, kurse në kategorinë B bëjnë pjesë boksierët juniorë dhe të rinj (17-18-vjeçar), derisa në kategorinë e tretë C janë boksieret seniore, juniore dhe të rejat (17-18-vjeçare). Përgatitjet do të fillojnë me grupin e parë (senior) nga sot 07-21 qershor dhe pastaj me grupet e tjera. Këto përgatitje pesëdhjetë për qind mbështeten nga Komiteti Olimpik i Kosovës. "Përgatitjet bazike do të zhvillohen në lartësi mbidetare 1200-1700 metra, ushtrime forcë, kondicion dhe qëndrueshmëri.



Tri herë në ditë, gjithnjë duke respektuar këshillat e dala nga OBSh, MSh dhe IKShP. Në stërvitje do të marrin pjesë maksimalisht 8-10 boksierë, gjithnjë duke e ruajtur distancën fizike 1.5 - 2 m", thuhet në njoftimin FBOXK-ja.

Në përgatitje udhëtuani: Bashkim Bajoku, Leotrim Rexhepi, Besfort Merlaku, Artan Shaqiri, Shpëtim Bajoku, Çlirim Zekaj, Patriot Behrami, Dionis Gashi, Besart Pireva. Trajner: Shefki Bogujevci dhe Kreshnik Shala.

54 futbollistë mbeten pa kontratë pas qershorit në Serinë A

ROMË, 7 QERSHOR - Futbollit italian po vijon përgatitjet për rikthimin që në fundjavën e ardhshme, por problematikat nuk mungojnë. 54 futbollistë të skuadrave të ndryshme të Serisë A do të jenë të lirë në fund të 30 qershorit, pasi u përfundon kontrata ose marrëveshja e huazimit dhe do të duhet t'u bashkohen klubeve që kanë pronësinë. Kështu duke nisur nga Juventusi, Giorgio Chiellini dhe Gigi Buffon janë dy futbollistët që prej 1 korrikut nuk do të kenë më detyrime ndaj klubit dhe bardhezintë kanë nisur punën për ta rrinovuar bashkëpunimin me ta. Duke qenë se bëhet fjalë për dy futbollistë legjendarë të klubit, nuk pritet të ketë vështirësi për ta gjetur gjuhën e përbashkët, por më shqetësuese mbetet situata në klube të tjera, që kanë një numër të lartë futbollistësh të huazuar. Një situatë e komplikuar paraqitet te Verona, që ka shumë futbollistë në huazim, përfshirë këtu edhe



emra si Amrabat dhe Rrahmani, të cilët i ka shitur në janar, por i ka mbajtur në huazim deri më 30 qershor. Te Milani nuk kanë ende një marrëveshje për ta zgjatur bashkëpunimin me yllin e skuadrës, Zlatan Ibrahimoviq, ndërsa edhe mesfushori Bonaventura do të jetë i lirë prej 1 korrikut, duke zvogëluar

mundësinë e zgjedhjeve për trajnerin Pioli. Nuk ka mbetur pa u prekur prej kësaj situate edhe Interi, që do të duhet të zgjasë të paktën përkohësisht huazimin e Alexis Sanchez, ndërsa edhe Borja Valero e Sensi nuk do të kenë detyrime kontratale pas datës 30 qershor.

SHKURT

Roma në garë për Hysajn

Roma po vazhdon t'i përcjellë dy lojtarët e Napolit, Elseid Hysaj e David Ospina, që pritet të lëvizin në këtë verë. Sipas "Calciomercato.com", Roma synon të transferojë dyshen e Napolit. Roma llogarit në përvojën e portierit Ospina, kurse Hysajn e vlerëson për paraqitjen në krah. Ka kohë që reprezentuesi i Shqipërisë, Hysaj, përmendet lidhur me largimin nga Napoli. 26-vjeçari ka kontratë me Napolin deri në vitin 2021. Ai ka humbur peshën që kishte te skuadra e Napolit më parë.

UEFA: Liga 1 mund të rifillojë para 2 gushtit, me sistemin 'play-off'-it

Shtëpia më e madhe e futbollit në Evropë, UEFA, i ka dhënë një mundësi interesante kampionatit francez. Liga 1 vendosi ta anulonte sezonin qysh në muajin prill, por që atëherë ligat e tjera kanë vendosur të rifillojnë. UEFA ka paralajmëruar se Liga 1 mund të rifillojë me "play-off", para 2 gushtit, përkundër faktit se kampionati është anuluar. Ky vendim vjen si pasojë e asaj se UEFA mendon që Liga 1 ka vendosur shumë herët për anulimin e sezonit. Kujtojmë se PSG-ja është skuadra që është shpallur kampione e Francës. Reagimet ishin të shumta, kurse Lyoni akoma vazhdon ta kërkojë rifillimin e sezonit.

Alvesi: Barça si Muhammad Ali

Në finalen e vitit 2015 në Ligën e Kampionëve, Barcelona e mposhti skuadrën e Juventusit (3-1). Sipas Dani Alves, brazilianit që atë kohë aktivizohej në krahun e djathë të mbrojtjes, Barça ishte si Muhammad Ali në atë ndeshje. "Ne luanim kundër një skuadre të fortë fizikisht dhe e dinim se duhet fituar duke mbajtur topin. Nuk kishte rëndësi sa të fortë ishin kundërshtarët, nëse i bënim të na ndjekin pas, derisa u lodhën", ka thënë Alves. "Në momentin kur ata dorëzohen, është momenti kur ti sulmon. Ne ishim si Muhammad Ali: Shkonim si flutura dhe thumbonim si bletët", ka shtuar brazilianin.

Silva, afër Evertonit

Mbrojtësi Thiago Silva është përfolur gjatë për një rikthim të mundshëm në skuadrën e Milanit, por një gjë e tillë duket se nuk do të ndodhë. Braziliani në afatin kalimtar të verës pritet të largohet nga skuadra e PSG-së, kurse favorit për t'i siguruar shërbimet e tij është Evertoni. Sipas mediave britanike, në këtë transferim po ndikon trajneri Carlo Ancelotti, i cili edhe në të kaluarën ka punuar me mbrojtësin brazilian. Silva aktualisht është 35-vjeçar, por ende ndihet i gatshëm të luajë në nivelet më të larta në futbollin evropian.

McGregor pensionohet për herë të tretë

Conor McGregor ka befasuar të gjithë adhuruesit e tij dhe ata të UFC-së, teksa ka lajmëruar se i ka dhënë fund karrierës së tij në MMA. Kjo nuk është hera e parë që irlandezit bën një lajmërim të tillë, pasi një gjë të tillë e kishte bërë edhe në muajin prill të vitit 2016 dhe në marsin e vitit 2019, por që më vonë u riktheje përsëri. Ish-kampioni i botës ka postuar një foto në rrjetin social "Twitter" së bashku me nënën e tij, teksha ka njofuar fansat se ka vendosur të tërhiqet. "Përshëndetje njerëz! Kam vendosur të tërhiqem nga luftimet. Faleminderit të gjithëve për një rrugëtim të jashtëzakonshëm! Ka qenë një rrugë fantastik. Këtu po postoj një foto timen së bashku me mamanë në Las Vegas pas triumfit të një prej titujve botërorë. Zgjidhe shtëpinë e endrrave Mags, të dua. Çka do që të dëshiron zemra, është e jotja", ka shkruar McGregor.

ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A. **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fludi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100 % mish puk

cilësi e garantuar

pa konservues